



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 20

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 3, datë 16.5.2002	Për krijimin e Komisionit Parlamentar për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001.....	629
Vendim i GjL nr. 1, datë 26.3.2002	Akuza: Kontrabandë.....	630
Vendim i GjL nr. 9, datë 16.1.2002	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.96, datë 1.7.1999 të Këshillit Bashkiak Shkodër.....	642
Vendim i GjL nr. 22, datë 13.3.2002	Me objekt pjesëtimin e pasurisë së palujatshme, në bazë të nenit 207 të Kodit Civil dhe 370 të Kodit të Procedurës Civile.....	648
Vendim i GjL nr. 23, datë 1.4.2002	Me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.2670/954, datë 5.8.1995, duke urdhëruar Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Palujatshme të bëjë çregjistrimin përkatës.....	652
Vendim i GjL nr. 24, datë 13.3.2002	Me objekt deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik, kontratë dhurimi.....	664

VENDIM
Nr. 36, datë 16.5.2002

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR PËR SHQYRTIMIN DHE ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË/ODIHR-IT PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE TË
VITIT 2001**

Në mbështetje të nenit 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës dhe të neneve 22, 30, 88 dhe 164 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijohet Komisioni Parlamentar Bipartizan (pozitë-opozitë) për shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve në Raportin Përfundimtar të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të 24 qershorit 2001.

II. Komisioni Parlamentar Bipartizan në përfundim të punës së tij i paraqet Kuvendit raport me propozimet konkrete (nisma ligjvënëse) për amendime në Kodin Zgjedhor.

III. Komisioni Parlamentar Bipartizan përbëhet nga 16 anëtarë, mbi bazën e barazisë pozitë-opozitë, nga ku 8 anëtarë janë të pozitës dhe 8 anëtarë të opozitës. Nga gjiri i vet, Komisioni me mirëkuptim midis grupeve parlamentare zgjedh dy bashkëkryetarë dhe sekretarin.

IV. Komisioni do të fillojë nga veprimtaria e tij ditën e miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi dhe do të përfundojë brenda 2 muajve nga krijimi i tij.

V. Vendimet e Komisionit merren me shumicë votash dhe quhen të miratuara kur votojnë "pro" përfaqësuesit e dy partive më të mëdha parlamentare.

VI. Komisioni vepron sipas procedurës së përcaktuar për komisionet e përhershme, nenet 52-68 të Rregullores së Kuvendit dhe për elementë të hetimit (inquiry) në përputhje me nenin 77 pikat 1, 2 e 3 të Kushtetutës.

VII. Vendimi i Kuvendit nr.15, datë 21.1.2002 "Për krijimin e Komisionit të Posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e rekomandimeve të OSBE-së/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare 2001" shfuqizohet.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Servet Pëllumbi

VENDIM
Nr. 1, datë 26.3.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Perikli Zaharia	Anëtar
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Irma Bala	“
Vladimir Bineri	“

Vladimir Metani	“
Zamir Poda	“
Bashkim Caka	“
Agron Lamaj	“
Metush Saraçi	“
Artan Hoxha	“
Ylvi Myrtja	“
Spiro Spiro	“

në seancën gjyqësore të datës 12.3.2002, morën në shqyrtim çështjen penale nr.1, që i përket:

TË PANDEHURVE:

1. Jorgaq Murati, i biri i Kristos, i dt.1954, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar, mbrojtur nga avokat Fatmir Braka.
2. Janaq Murati, i biri i Kristos, i dt.1960, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
3. Arjana Heba, e bija e Llazarit, e dt.1961, banuese në Tiranë, në mungesë, mbrojtur nga avokat Mark Pëllumbi.
4. Vladimir Molla, i biri i Islamit, i dt.1962, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
5. Astrit Fejzo, i biri i Abazit, i dt.1950, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
6. Gëzim Piluri, i biri i Harrizit, i dt.1959, banues në Tiranë, në mungesë.
7. Genci Gjata (Doraci), i biri i Jakupit, i dt.1962, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar, mbrojtur nga avokat Remzi Kruja.
8. Edvin Nuku, i biri i Gasprit, i dt.1971, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar, mbrojtur nga avokat Remzi Kruja.
9. Selaudin Uruçi, i biri i Sadikut, i dt.1956, banues në Peshkopi, me arsim të lartë, i padënuar.
10. Arif Murrja, i biri i Seferit, i dt.1972, banues në Peshkopi, me arsim të lartë, i padënuar.
11. Robert Maliqi, i biri i Dalipit, i dt.1967, banues në Vlorë, në mungesë.
12. Sokol Alija, i biri i Koçiut, i dt.1960, banues në Tiranë, me arsim të lartë, i padënuar.
13. Edmond Voda, i biri i Idajetit, i dt.1967, banues në Tiranë, i padënuar, në mungesë.
14. Xhetan Qoku, i biri i Qazimit, i dt.1968, banues në Peshkopi, me arsim të mesëm, i padënuar.
15. Rami Toçi, i biri i Destanit, i dt.1955, banues në Maqellarë (Peshkopi), i padënuar.
16. Flamur Burnazi, i biri i Tofikut, i dt. 1962, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
17. Harilla Taçi, i biri i Theodorit, i dt.1954, banues në Tiranë, me arsim të mesëm, i padënuar.
18. Aleks Murati, i biri i Kristos, banues në Tiranë me arsim të mesëm, i padënuar, në mungesë.

TË AKUZUAR: Shtatëmbëdhjetë të parët, për krimin e kontrabandës nga punonjës të doganave, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 175, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

I pandehuri Janaq Murati edhe për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, të kryer në bashkëpunim me të pandehurin Aleks Murati, parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe, veçmas, edhe për krimin e largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit, parashikuar nga neni 323/1 të Kodit Penal.

I pandehuri Aleks Murati, për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, në bashkëpunim me të pandehurin Janaq Murati, parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.634, datë 21.10.1999, ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurve Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba dhe Aleks Murati, për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 172, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, duke aplikuar këtë dispozitë për të pandehurin Janaq, dy herë.

I pandehuri Janaq Murati është deklaruar fajtor edhe për krimin e largimit të të burgosurit nga vendi i qëndrimit, parashikuar nga neni 323/1 i Kodit Penal.

Duke aplikuar edhe nenin 49 të Kodit Penal, i dënoi:

- të pandehurin Jorgaq Murati me 5 (pesë) vjet burgim.

- të pandehurin Janaq Murati për krimin e parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal, me 4 (katër) dhe 1 (një) vit burgim, kurse për krimin e parashikuar nga neni 323 i Kodit Penal me 2 (dy) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, të pandehurin Janaq Murati e dënoi, përfundimisht, me 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Të pandehurën Arjana Heba, me 3 (tre) vjet burgim.

Të pandehurin Aleks Murati, me 500 mijë lekë gjobë.

2. Deklarimin fajtorë të të pandehurve: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja, Robert Maliqi, Sokol Alija, Edmond Voda dhe Xhetan Qoku për krimin e shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe duke aplikuar, për të njëmbëdhjetë këta, nenet 48 e 49 të këtij Kodi, i dënoi respektivisht me: 1 (një) vit burgim (Vladimirin), 1 (një) vit burgim (Astritin), 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me heqjen e të drejtës të ushtrimit të detyrës së punonjësit të doganave dhe detyrave drejtuese, nenet 35 e 40 të Kodi Penal (Gëzimin), 1 (një) vit burgim (Gencin), 2 (dy) vjet burgim (Edvinin), me kohën e paraburgimit (Selaudinin dhe Arifin), me 500 mijë lekë gjobë (Robertin), me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim (Sokolin), me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim (Edmondin) dhe me kohën e paraburgimit (Xhetanin).

3. Deklarimin fajtorë të të pandehurve Flamur Burnazi e Harilla Taçi për krimin e moskallzimit të kimit, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe i dënoi me kohën e paraburgimit.

4. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit Rami Toçi.

5. Zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, duke u detyruar, solidarisht të pandehurit Jorgo Murati, Janaq Murati e Arjana Heba, t'i paguajnë shtetit shumën prej 448.864 dollarë ose 62.840.960 lekë, shumë që përfaqëson detyrimet doganore të shmangura dhe lënien në fuqi të të gjithë sekuestrore të vendosura.

6. Zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, duke u detyruar, solidarisht, të pandehurit Janaq e Aleks Murati, t'i paguajnë shtetit shumën 4.866 dollarë ose 680.960 lekë, shumë që përfaqëson detyrimet doganore të shmangura, në bashkëpunim midis tyre.

7. Në zbatim të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, sendet e bllokuara si provë materiale, të kalojnë në favor të shtetit.

Gjykata Apelit Tiranë, me vendimin nr. 94, datë 10.3.2000, ka vendosur:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 634, datë 21.10.1999 për të pandehurit: Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba, Xhetan Qoku, Flamur Burnazi, Harilla Taçi dhe Aleks Murati.

2. Ndryshimin e tij përsa i takon cilësimit ligjor të veprës dhe llojit e masave të dënimit për të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja, Robert Maliqi dhe Sokol Alija.

3. Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, në bazë të nenit 428/c të Kodit të Procedurës Penale për të pandehurin Edmond Voda.

4. Mospranimin e ankimit për shkak të heqjes dorë nga prokurori, (nenet 418 e 420/ç të Kodit të Procedurës Penale), për të pandehurin Rami Toçi.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 268, datë 19.7.2000, vendosi: prishjen e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit për shkelje të ligjit material dhe procedural dhe kthimin e akteve për rishqyrtim, në po atë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

Pas rigjykimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 546, datë 18.12.2000, vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.634, datë 21.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë për të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Genci Gjata (Doraci), Arif Murrja, Xhetan Qoku, Rami Toçi, Aleks Murati, Fatmir Burnazi dhe Harilla Taçi.

2. Lënien në fuqi të këtij vendimi, përsa i takon cilësimit ligjor të veprës dhe ndryshimin e tij për masat e dënimit për të pandehurit: Robert Maliqi, Sokol Alija, Gëzim Piluri, Edvin Nuku dhe Selaudin Uruçi, duke i dënuar, respektivisht, me 300 mijë lekë gjobë (Robertin), 500 mijë lekë gjobë (Sokolin), 3 (tre) vjet burgim (Gëzimin), 500 mijë lekë gjobë (Edvinin), kurse të pandehurin Selaudin, me kohën e paraburgimit dhe meqenëse me vendimin nr. 54, datë 30.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndryshuar me vendimin nr. 128, datë 31.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të neneve 175, 25 të Kodi i Procedurës dhe 406 të Kodi i Procedurës Penale ka qenë i dënuar me 2 (dy) vjet burgim, në zbatim të nenit 56 të Kodit Penal, e dënoi përfundimisht, me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.

3. Prishjen e vendimit nr. 64, datë 21.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pushimin e çështjes për të pandehurin Edmond Voda.

4. Ndryshimin e këtij vendimi për të pandehurit Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Arjana Heba, duke i deklaruar fajtorë për krimin e kontrabandës me regjim të ndërmjetëm, të kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 177, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, i dënoi, respektivisht, me 2 (dy) vjet e 8 (tetë) muaj burgim (Jorgaqin), me nga 2 (dy) vjet burgim (Janaqin dhe Arjanën). Për të pandehurën Arjana, u urdhërua pezullimi i ekzekutimit të vendimit për 5 vjet kohë.

Në aplikim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gëzim Piluri, Genci Gjata, Arif Murrja, Selaudin Uruçi dhe Xhetan Qoku u dënuan dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit në dogana dhe financë për 3 (tre) vjet kohë.

Kundër vendimit nr. 546, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë: Prokuroria e Apelit Tiranë dhe të gjykuarit Gëzim Piluri, Janaq Murati, Jorgaq Murati dhe Arjana Heba, me të cilin kërkojnë:

Prokuroria: Ndryshimin e tij, përsa i takon cilësimit ligjor të veprës për të gjykuarit Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Robert Maliqi, Arif Murrja dhe Xhetan Qoku, duke e cilësuar veprën e kryer prej tyre si kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 177, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, si dhe përsa i përket masës së dënimit për të gjykuarit Jorgaq Murati dhe Janaq Murati, duke e lënë caktimin e kësaj mase në çmimin e gjykatës.

I gjykuarit Gëzim Piluri: Ndryshimin e tij, përsa i takon llojit dhe masës së dënimit, duke caktuar gjobë ose dënim me burgim, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit me kohë maksimale prove.

Të gjykuarit Janaq Murati, Jorgaq Murati dhe Arjana Heba kërkojnë prishjen e vendimit dhe deklarimin e pafajshëm të tyre.

Në rekurset e paraqitura, parashtohen shkaqet e mëposhtme:

Prokurori i Apelit:

- Vendimi i Gjykatës së Apelit është i gabuar përsa i përket cilësimit ligjor të veprës për të pandehurit Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Robert Maliqi, Sokol Alija, Gëzim Piluri, Genci Doraci, Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja dhe Xhetan Qoku, pasi në vendimin e saj nuk argumenton se çfarë veprime konkrete nga ato që pengojnë zbatimin e një ligji konkret, ka kryer secili prej tyre, sikundër kërkohet në nenin 248 të Kodit Penal.

- Përkundrazi, duke pranuar se të pandehurit Janaq Murati, Jorgaq Murati e Arjana Heba kanë konsumuar veprën penale të kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, duhet të pranohet se këtë vepër ata e kanë kryer në bashkëpunim me 10 të pandehurit punonjës të sektorit doganor të Tiranës dhe të Bllatës.

Pa një marrëveshje paraprake midis të pandehurve Jorgaq, Janaq dhe Arjana dhe të pandehurve të tjerë – punonjës të doganave Tiranë e Bllatë nuk mund të realizohej kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm, pasi çdo hallkë e vendit të punës, që i përkiste secilit prej këtyre të pandehurve, ishte pengesë për realizimin e veprës penale.

- Vendimi i Gjykatës së Apelit është i gabuar edhe në caktimin e masës së dënimit për të pandehurit Janaq e Jorgaq Murati, duke i dënuar me kohën e paraburgimit, pasi pasojat e ardhura nga vepra penale e kryer prej tyre paraqet rrezikshmëri të theksuar.

I gjykuari Gëzim Piluri: Ndryshe nga detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit nuk hetoi dhe nuk analizoi veprimet e kryera nga secili i pandehur dhe, konkretisht, nga unë, mbasi unë kam qenë në punë vetëm më 18 dhjetor 1998, që është data e kalesës së parë, kurse më 26 dhjetor 1998 nuk kam qenë në punë dhe nuk kam dijeni se çfarë ka ndodhur.

- Gjykata, në caktimin e llojit dhe masës së dënimit tim, nuk mori parasysh as faktin që unë jam i sëmurë, as rrethanat lehtësuese të parashikuara nga nenet 48 e 49 të Kodit Penal. Po kështu, nuk morri parasysh as faktin që dispozita e Kodit Penal me të cilën është kualifikuar vepra e kryer prej meje, përveç dënimit me burgim, parashikon edhe gjobë.

I gjykuari Janaq Murati: (nëpërmjet mbrojtësit, avokat B.Mane):

- Përveç lidhjeve familjare me Jorgaq Muratin, Aleksandër Muratin dhe Arjana Hebën, nuk më lidh asgjë tjetër me veprimtarinë për të cilën akuzohem. Shoqëria “Murati Do Brazil”, bashkëpronar i së cilës jam, ka patur vetëm marrëdhënie huapërdorje me shoqërinë “OJAL” sh.p.k., e cila është pronare e mallit dhe magazinës doganore, mall i cili është shitur tek të tretët nga vetë kjo shoqëri. Të dy këto shoqëri kanë pasur administratorë të veçantë.

-Veç kësaj, gjatë periudhës për të cilën bëhet fjalë në vendimin e gjykatës ndodhesha i shtruar jashtë shtetit.

- Në kryerjen e ekspertimit kontabël nuk janë respektuar rregullat procedurale dhe, për rrjedhojë, konkluzionet e dyshimta të tij u morrën si prova të mirëqena nga ana e gjykatës.

- Përsa i takon zgjidhjes së padisë civile, është vepruar në kundërshtim me nenet 61 e 62 të Kodit të Procedurës Penale.

- Në lidhje me deklarinin faktor për kontrabandën që është pranuar se është bërë në bashkëpunim me Aleks Muratin, gjykata ka interpretuar gabim ekzistencën e bashkëpunimit midis meje dhe Aleksit.

- Për akuzën e largimit nga vendqëndrimi i detyrueshëm, çështja duhej të ishte pushuar për mungesë të anës subjektive.

- Përsa i takon llojit dhe masës së dënimit, në caktimin e saj, gjykata nuk morri parasysh gjendjen time shëndetsore.

I gjykuari Jorgaq Murati:

- Kafeja e importuar nga Greqia ishte e firmës “OJAL” sh.p.k. dhe nuk kishte asnjë lidhje me firmën “Murati Do Brazil”, në të cilën jemi vetëm dy ortakë, unë dhe vëllai im Janaqi. Gjykatat kanë gabuar në interpretimin e marrëdhënieve juridiko-civile që ekzistojnë midis këtyre dy firmave.

- Gjykatat nuk patën parasysh pikën 5/a të udhëzimit nr.1, datë 20.11.1996 “Për Kodin Doganor” në lidhje me kohëzgjatjen e mallrave me regjim të përkohshëm.

- Gjykatat kanë gabuar në vlerësimin e procedurave që u ndoqën për rieksporimin e kafesë, në kushtet kur dhe magazinat administroheshin nga dogana dhe transporti i kafesë ishte në ekskluzivitetin e doganës.

- Nuk janë patur parasysh kërkesat e ligjit për statusin e agjentit doganor, i cili ishte nënshkruar në deklaratën doganore.

- Në bazë të kontratës që ishte lidhur me Jonuz Muçën, pronësia mbi gjithë sasinë e kafesë i kishte kaluar këtij të fundit që në magazinat e Saukut.

- Gjatë kryerjes së ekspertimeve grafike dhe kontabël nuk janë respektuar kërkesat e neneve 178,179/2,181 dhe 325 të Kodit të Procedurës Penale.

- Gjykatat kanë gabuar në zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, pasi nuk dimë që organi i akuzës të ketë ngritur padi civile para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Nuk është ngritur edhe gjatë gjykimit të çështjes padi civile që të plotësonte kërkesat e Kodit të Procedurës Civile për padinë.

- Në kushtet kur të pandehurit e kësaj çështjeje janë shumë, për të cilët gjykatat kanë pranuar se kanë vepruar në bashkëpunim, si është e mundur që civilisht janë detyruar vetëm ortakët e firmës “Murati Do Brazil” (Jorgaqi dhe Janaqi).

- Edhe cilësimi ligjor i veprës së kontrabandës është i gabuar pasi mungon subjekti, si dhe pasi nuk ka kalim të mallit duke iu shmangur kontrollit doganor.

E gjykuara Arjana Heba (nëpërmjet avokatit Mark Pëllumbi):

- Nuk i jam shmangur asnjë detyrimi doganor dhe nuk kam fshehur mall.

- Magazina doganore ka qenë në administrim të përbashkët, timin dhe të doganës. Kjo e fundit ka bërë të gjitha praktikat doganore pas përfundimit të kontratës së shitjes së kafes, prandaj nuk del se cili është mekanizmi i kontrabandës për të cilën akuzohem.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 696, datë 19.11.2001, vendosi dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të bërë njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje më çështjet e mëposhtme:

1. A konkurrojnë me njëra-tjetrën figurat e krimit të kontrabandës, që janë parashikuar në seksionin e V-të, të kreut të III-të të Kodit Penal (nenet 171-177 të Kodit Penal)?

2. A konkurron figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i këtij Kodi?

3. Në rastet kur kontrabanda kryhet në bashkëpunim midis dy ose më shumë personave, të gjithë bashkëpunëtorët do të përgjigjen sipas të njëjtës dispozitë të Kodit Penal, ose një apo disa prej tyre do të përgjigjen sipas një dispozite të Kodit Penal, e cila parashikon një lloj kontrabande dhe një apo disa të tjerë do të përgjigjen sipas një dispozite tjetër, e cila parashikon një lloj tjetër kontrabande?

4. Si do të përcaktohet përgjegjësia e bashkëpunëtorëve në rastet kur të gjithë ata janë në rolin e bashkekzekutorit?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionet e anëtarëve Spiro Spiro dhe Ylvi Myrtja, prokurorin Bilbil Mete, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 546, datë 12.12.2000, si më poshtë:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Jorgaq Murati, për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit Janaq Murati për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij për këtë krim me 6 vjet burgim dhe për krimet e parashikuara nga nenet 172, 25 e 323/I të Kodit Penal dhe dënimin e tij për këtë krim me 2 (dy) vjet dhe 6 muaj burgim.

- Deklarimin fajtor të të pandehurës Arjana Heba për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 vjet burgim; deklarin fajtor të të pandehurit Vladimir Molla për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Astrit Fejzo për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Gëzim (Harris) Piluri për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Genci Gjata (Doraci) për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohe; deklarin fajtor të të pandehurit Edvin Nuku për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Selaudin Uruci për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Arif Murrja për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë; deklarin fajtor të të pandehurit Robert Maliqi për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohe; deklarin fajtor të të pandehurit Sokol Aliaj për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 6 vjet burgim, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës dogane për 5 vjet kohë;

deklarimin fajtor të të pandehurit Xhetan Qoku për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodi Penal dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si punonjës policie për 5 vjet kohë; deklarimin fajtor të të pandehurit Rami Toçi për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit, si dhe me heqjen e të drejtës së ushtrimit të detyrës si agjent doganor për 5 vjet kohë; deklarimin fajtor të të pandehurit Flamur Burnazi për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit; deklarimin fajtor të të pandehurit Harilla Taçi për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit; deklarimin fajtor të të pandehurit Aleks Murati për veprën penale, parashikuar nga nenet 175 e 25 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 500.000 lekë gjobë; mbrojtësit e të pandehurve: Jorgaq Murati (avokat Fatmir Braka), Arjana Heba (avokat Mark Pëllumbi), Genci Gjata e Edvin Nuku (avokat Remzi Kruja), të cilët kërkuan pafajësi për klientët e tyre dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Nga shqyrtimi i akteve që ndodhën në fashikullin e procedimit penal nr. 801, si edhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezultoi se të gjykuarit Jorgaq e Janaq Murati – (vëllezër) ishin ortakë të shoqërisë tregtare “Murati do Brazil” – sh.p.k., me seli në Tiranë, me objekt, përveç të tjerave, edhe import-eksportin e kafesë, themeluar më 6.7.1995.

Më 1.7.1998, e gjykuara Arjana Heba (bashkëshortja e të pandehurit Jorgaq) themeloi një shoqëri tjetër tregtare, me emërtimin “OJAL” – sh.p.k., ortake e së cilës ishte vetem ajo. Objekti i kësaj shoqërie ishte import – eksporti i mallrave të ndryshëm.

Si gjykata e rrethit gjyqësor, ashtu edhe ajo e Apelit Tiranë, bazuar në provat që u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor, arritën në përfundimin se shoqëria tregtare “OJAL” – sh.p.k. u krijua në marrëveshje midis tre të gjykuarve që u përmendën më lart, jo për të ushtruar aktivitetin që ishte parashikuar formalisht në aktet e themelimit të saj, por me pikësynimin që të shërbente si hallkë ndërmjetëse për realizimin e veprimtarisë keqbërëse në fushën e kontrabandës, ashtu sikurse ndodhi disa muaj më vonë, përfundim i cili u gjet plotësisht i drejtë, i bazuar në ligj e në prova edhe nga Gjykata e Lartë.

Për vënien në jetë të këtij pikësynimi, rreth një muaj pas pajisjes me autorizimin përkatës për Magazinë Doganore, në magazinën e shoqërisë tregtare “OJAL” –sh.p.k, që ishte marrë gjoja me qera, më 17.8.1998, nga shoqëria tregtare “Murati do Brazil” –sh.p.k., u magazinuan 223.853 kg kafe kokërr e pabluar, importuar në datat 25 shtator dhe 7 tetor 1998 nga Greqia.

Magazinimi i kësaj sasive kafeja u bë si mall me regjim të ndërmjetëm, në kushtet e Magazinës Doganore, parashikuar nga kreu i IV-të i pjesës së III-të të Kodit Doganor, miratuar me ligjin nr. 7599, datë 2.9.1992, që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së këtij veprimi.

Sipas dokumentacionit që është paraqitur nga shoqëria tregtare “OJAL” – sh.p.k., e gjithë kjo sasi kafeje figuron sikur është rieksportuar në Republikën ish - Jugosllavisë të Maqedonisë në datat 16 dhe 29 dhjetor 1998, ngarkuar në 7 kamiona, nëpërmjet Pikës Doganore Bllatë (Peshkopi), dokumentacion, i cili, me të drejtë, është konsideruar fiktiv nga ana e gjykatave të dy shkallëve të gjykimit të çështjes.

Të dy këto gjykata arritën në përfundimin se, falsifikimi i dokumentacionit për gjoja rieksportimin e kësaj sasive kafeje u krye nga të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Arjana Heba, në bashkëpunim me nëntë nga të gjykuarit e tjerë të kësaj çështjeje dhe, konkretisht, me të gjykuarit: Astrit Fejzo, Vladimir Molla (të dy doganierë të kontrollit fizik në Doganën Tiranë), Robert Maliqi, Sokol Alia (të dy – policë doganorë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; Roberti – përgjegjës grupi), Gëzim Piluri, Genci Gjata, Selaudin Uruçi, Edvin Nuku dhe Arif Murrja (të pestë punonjës të Pikës Doganore Bllatë; Gëzimi – drejtor i kësaj dogane), përfundim i cili edhe ky u gjet i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, pasi u konstatua se është rezultat i analizës logjike dhe në përputhje me kërkesat e ligjit që u është bërë, në tërësi, rrethanave dhe provave që u administruan gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të tyre.

Kolegjet e Bashkuara të kësaj Gjykate arritën në përfundimin se drejt ka vepruar gjykata e apelit edhe përsa i përket cilësimit ligjor të veprës për të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Arjana Heba, duke e ndryshuar atë nga kontrabandë me mallra për të cilat paguhet akcizë, parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal, që e kishte cilësuar gjykata e shkallës së parë, në kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 177, në lidhje me nenin 25 të këtij Kodi. Të drejta këto Kolegje vlerësojnë edhe llojet dhe masat e dënimit që janë caktuar për këta të gjykuar nga gjykata e apelit.

Por, përsa i përket cilësimit ligjor të veprës penale për nëntë të gjykuarit e tjerë që, ashtu sikurse u përmend më lart, kanë vepruar në bashkëpunim me të gjykuarit Jorgaq, Janaq e Arjana dhe, konkretisht, për të gjykuarit: Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gëzim, Genci, Selaudin, Edvin e Arif, si shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se duhet ndryshuar vendimi i kësaj Gjykate (vendimi nr. 546, datë 18.12.2000), duke e cilësuar veprën e kryer prej tyre si kontrabandë nga punonjës të doganave, krim ky që parashikohet nga neni 175 i Kodit Penal.

Në këtë përfundim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën duke u nisur:

Së pari, nga fakti që, ashtu sikurse përcaktohet në nenin 64 të Kodit Doganor, miratuar me ligjin nr. 7599, datë 2.9.1992, që ishte në fuqi në kohën kur është kryer vepra, çdo veprim ose falsifikim, i cili ka për objekt shmangien e kontrollit doganor të mallrave, përbën kontrabandë dhe, së dyti, nga fakti që nëntë të gjykuarit, emrat e të cilëve u përmendën me rradhë në paragrafin e mëparshëm të këtij vendimi, kanë vepruar në bashkëpunim me të gjykuarit Jorgaq, Janaq e Arjana, duke qenë në rolin e bashkëpunuesve të kryerjes së veprës penale të kontrabandës në lidhje me gjoja rieksporimitin e 223.853 kg kafe, mall ky që, ashtu sikundër u tha, ishte vendosur në regjim të ndërmjetëm, në kushtet e magazinës doganore.

Të dy këto figura vepre penale, sipas të cilave është cilësuar vepra e kryer nga dymbëdhjetë të gjykuarit e përmendur më lart, bëjnë pjesë në seksionin e V-të të kreut të III-të të Kodit Penal në të cilin përfshihen veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike.

Në këtë seksion (seksioni i V-të) ligjvënësi ka përfshirë krimet në fushën e doganave, duke i ndarë në nëntë figura të veçanta krimi (nenet 171-179 të Kodit Penal), të cilat, me përjashtim të figurave të krimit parashikuar nga nenet 178 (tregtimi i mallrave që janë kontrabandë) dhe 179 (ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë), janë forma specifike të figurës së përgjithshme të kontrabandës, variante të veçanta të saj.

Në këtë përfundim arrihet pasi objektin e përgjithshëm të gjithë këtyre figurave të veçanta krimi, që përfshihen në këtë seksion, e përbëjnë të njëjtat marrëdhënie shoqërore. E përbëjnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdolloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve doganore, të cilat, në analizë të fundit, llogariten në të holla.

Ndarja e figurës së përgjithshme të krimit të kontrabandës në shtatë figura të veçanta kontrabande është bërë nga ligjvënësi duke u nisur, së pari, nga natyra e mallrave me të cilat bëhet kontrabanda, regjimi juridik i tyre; së dyti, nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të secilit prej këtyre llojeve të kontrabandës dhe, së fundi, nga subjekti, duke krijuar, kështu, kushte ligjore të përshtatshme për të bërë të mundur zhvillimin e një lufte sa më efektive kundër kriminalitetit në një sferë aq të rëndësishme të ekonomisë, siç është ajo e veprimtarisë së organeve të doganës.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se të dymbëdhjetë të gjykuarit që u përmendën më lart, duke marrë pjesë aktive, me veprimet e kryera prej tyre, krijuan dokumentacion fiktiv, në formë zinxhiri të pandërprerë, duke paraqitur në të sikur sasia prej 223.853 kg kafe kokërr e pablur që, sikurse u tha, në datat 25.9.1998, dhe 7.10.1998 ishte magazinuar në magazinën doganore të shoqërisë "OJAL"-sh.p.k. që ndodhet në Sauk (Tiranë) dhe sikur kjo sasi kafeje, në datat 16 dhe 25.12.1998, u transportua, tranzit, për në Doganën e Bllatës (Peshkopi) dhe që atje, sikur u eksportua, duke përpiluar përsëri dokumente fiktivë për gjoja eksportin që u bë nëpërmjet kontrollit doganor, kanë bërë kontrabandë në kuptimin që u dha në pjesët e mëparshme të këtij vendimi për figurën e përgjithshme të krimit të kontrabandës.

Rezultati kriminal i arritur nëpërmjet kësaj veprimtarie, shmangia nga kontrolli doganor, duke mos paguar në buxhet shumën 62.840.960 lekë, sikundër me të drejtë kanë pranuar gjykatat e dy shkallëve të gjykimit të çështjes, ka ardhur si rrjedhojë direkte e veprimeve të kundërligjshme të kryera nga të gjithë të gjykuarit e përmendur, të cilët vepruan me marrëveshje dhe në bashkëpunim midis tyre, në rolin e bashkekzekutorit të kësaj veprimtarie kriminale.

Marrëveshja, që është një elementët e domosdoshëm për të patur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, madje më kryesori, mund të vendoset jo vetëm midis organizatorit, ekzekutorit, shtytësit dhe ndihmësit që përbën formën klasike të bashkëpunimit. Ajo mund të vendoset edhe midis vetë ekzekutorëve të veprës penale, (në rastet kur ata janë dy ose më shumë persona) dhe në këtë rast do të ndodhemi para bashkëpunimit për të kryer vepër penale në formën e bashkekzekutimit të saj.

Për të pasur këtë formë bashkëpunimi, kërkohet që secili nga personat që marrin pjesë në realizimin e veprës penale ose, thënë ndryshe, secili nga bashkekzekutorët, të kryejë veprime që të kenë lidhje të drejtë përdrejtë shkakësore me pasojën e dëshiruar nga të gjithë të tjerët dhe që vjen si rezultat i këtyre veprimeve të kryera nga secili prej bashkekzekutorëve d.m.th. secili nga bashkekzekutorët me veprimin apo veprimet e tij, të marrë pjesë direkt në realizimin e anës objektive të veprës penale.

Në të njëjtën kohë, kërkohet që veprimet e secilit prej bashkekzekutorëve të jenë rezultat i realizimit jo i dëshirave individuale të tij, por të jenë rezultat i realizimit të vullnetit të përbashkët të të gjithë bashkekzekutorëve të një veprimtarie të caktuar, konkrete, kriminale.

Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën e bashkekzekutimit, midis bashkëpunëtorëve nuk ka më ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale (ndarje në rolet organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarjeje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkte që duhet të kryejë secili nga bashkekzekutorët për realizimin e vullnetit të përbashkët kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit, manifestohet në botën e jashtme, veç veprimeve të secilit, edhe me arritjen e rezultatit kriminal të dëshiruar prej tyre.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatuan që secili prej të gjykuarve Jorgaq, Janaq, Arjana, Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gezim, Genci, Selaudin, Edvin dhe Arif kanë kryer veprime aktive që kanë lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me rezultatin kriminal, që erdhi si rezultat i kontrabandës që u bë më 223.853 kg kafe, që kishin qenë të magazinuara, me statusin e rregjimit të ndërmjetëm doganor në magazinën doganore të shoqërisë tregtare “OSAL” - sh.p.k.

Veprimtaria e të gjithë e këtyre të gjykuarve, duke vepruar në grupe (dyshe dhe pesëshe) sipas fazave që ishin të nevojshme për arritjen e qëllimit final, shmangies nga pagimi i detyrimeve doganore ndaj shtetit, u zhvillua në formë zinxhiri.

Zinxhiri filloi me veprimtarinë e të gjykuarve Jorgaq, Janaq e Ariana, te cilët, ashtu siç, me të drejtë pranojnë, si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe ajo e apelit, me shpenzimet, mjetet dhe objektet e dy të parëve, sajuan themelimin e shoqërisë tregtare “OJAL” sh.p.k. ortake e vetme e së cilës ishte e gjykuara Ariana, siguruan autorizimin e kësaj të fundit për magazinë doganore, ku magazinuan në fakt 223.853 kg kafe, eksportuar nga Greqia dhe vazhdoi me përpilimin e procesverbaleve fiktive për gjoja ngarkimin e kësaj sasive kafeje në shtatë automjete, në datat 16 dhe 25 dhjetor 1998, nga ana e të gjykuarve Astrit e Vladimir dhe me dy procesverbale të tjera, po fiktive, për gjoja dorëzimin e këtyre automjeteve të gjykuarve Robert e Sokol, që kryenin detyrën e policëve doganore, të cilët firmosën sikur i kishin marrë në dorëzim këto automjete dhe sikur i kishin shoqëruar tranzit deri në Doganën e Bllatës.

Në Bllatë figuron sikur të gjykuarit e tjerë, Gëzim, Genci, Selaudin, Edvin dhe Arif, veprimet e të cilëve përbëjnë dhe hallkën e fundit të këtij zinxhiri, përpiluan dokumentacionin fiktiv për gjoja eksportimin e kësaj sasive kafeje në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Fakti që, po të mos kishte funksionuar qoftë edhe njëra prej hallkave të këtij zinxhiri, kontrabanda, objekt i këtij gjykimi nuk do të ishte realizuar, shërben edhe si një rrethanë tjetër për të krijuar bindjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë se këta të gjykuar kanë qenë bashkekzekutorë të kësaj kontrabande dhe duhet të përgjigjen si të tillë.

Përsa i përket përcaktimit të përgjegjësisë, konkretizimit të saj, në kuptim të cilësimit ligjor të veprës, për secilin prej këtyre të gjykuarve, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga fakti që, ashtu sikurse u përmend edhe në pjesët e mëparshme të këtij vendimi, në Kodin Penal, nuk parashikohet një figurë krimi e vetme kontrabandë, por shtatë të tilla dhe duke pasur parasysh sa u parashtruan më lart, në lidhje me pjesëmarrjen e secilit prej të dymbëdhjetë të gjykuarve të sipërpërmendur, secili prej tyre do të përgjigjet penalisht si bashkekzekutor në krimin e kontrabandës në një nga format e saj.

Duke u nisur nga rrethanat faktike të kësaj çështjeje ku, sikurse rezultoi e provuar, kafeja me të cilën u zhvillua kontrabanda, për shkak të statusit të magazinës doganore që kishte, ishte mall me regjim të ndërmjetëm dhe ligjvënësi për kontrabandën e zhvilluar me mallra të këtij lloji ka parashikuar një figurë të posaçme krimi, të cilën e ka emërtuar “Kontrabandë me mallra me regjim të ndërmjetëm” (neni 177 i Kodit Penal), Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se një pjesë e këtyre të gjykuarve dhe, konkretisht, të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Ariana Heba duhet të përgjigjen penalisht për këtë veper penale, sikurse me të drejtë është cilësuar vepra e kryer prej tyre edhe nga gjykata e apelit.

Ndërsa, duke u nisur nga fakti që të gjykuarit e tjerë: Astrit Fejzo, Vladimir Molla, Robert Maliqi, Sokol Alia, Gëzim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Selaudin Uruçi, Edvin Nuku dhe Arif Murrja, që morën pjesë si bashkekzekutorë të kësaj kontrabande, kanë qenë punonjës të doganave (doganierë dhe punonjës të policisë doganore), megjithëse do të përgjigjen penalisht po për kontrabandë, vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet me nenin 175 të Kodit Penal që parashikon kontrabandën e kryer nga punonjës të doganave.

Është e vërtetë që, ashtu sikurse pretendohet në rekursin e paraqitur nga organi i prokurorisë, (pretendim ky i përsëritur edhe nga përfaqësuesi i këtij organi gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë) kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si rregull, bashkëpunëtorët duhet të përgjigjen për veprën penale të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Por, kjo ka të bëjë me përgjegjësinë penale të bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale në rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike të roleve, në organizatorë, shtytës dhe ndihmës, dhe jo edhe kur shtrohet problemi i përgjegjësisë penale të bashkekzekutorëve të një veprë penale, ku, siç u përmend, ndodhemi përpara ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në një veprimtari të caktuar kriminale, sikurse në rastin në gjykim, dhe jo përpara ndarjes së roleve.

Në këtë përfundim arrihet duke u nisur edhe nga përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 27 të Kodit Penal.

Sipas kësaj dispozite, organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi, si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre në kuptimin që edhe vepra e secilit prej tyre do të cilësohet nga gjykata me atë dispozitë të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, me të cilën do të cilësohet vepra e kryer nga ekzekutori.

Në rastin konkret, në kushtet kur nga aktet e hetimeve paraprake dhe nga provat e administruara gjatë gjykimit, nuk është e mundur të përcaktohet organizatori/ët e kësaj veprimtarie, por, sikurse u përmend, ndodhemi jo para ndarjes së roleve, por para ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në realizimin e kontrabandës së 223.853 kg kafeje, problemi i përgjegjësisë penale të çdonjërit prej tyre, në kuptimin e cilësimit ligjor të veprës të secilit do të zgjidhet, duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të bashkëpunimit në formën e bashkekzekutimit, që u përmendën në pjesët e mëparshme të këtij vendimi, duke e vënë secilin prej tyre në të njëtin rol bashkëpunimi në atë të bashkekzekutorit të veprës penale.

Dhe meqenëse, problemi tashmë shtrohet për përgjegjësinë penale jo të bashkëpunëtorëve në kuptimin klasik, por të bashkekzekutorëve të veprës penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga parimet e përgjithshme të doktrinës të së drejtës penale sipas të cilave kur ndodhemi para figurave specifike të veprës penale (delictum proprium), në të cilat bashkekzekutimi është i mundur vetëm midis personave që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta për të qenë subjekte të disa veprave penale, (subjekte të posaçme), vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës së Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, subjekt i të cilës mund të jenë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta.

E tillë është edhe figura e krimit të kontrabandës nga punonjës të doganave parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal.

Pikërisht, në kuadrin e reflektimit të këtyre parimeve, në ndryshimet që i janë bërë kësaj dispozite me ligjin nr. 8733, datë 24.1.2001, ligjvënësi, veprimtarinë e kontrabandës që kryhet nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, e ka përfshirë në nenin 175 të Kodit Penal edhe në rastet kur kontrabanda, prej këtyre punonjësve, kryhet në bashkëpunim me persona të tjerë, të cilëve u mungon elementi i cilësive të veçanta për të qenë subjekt i posaçëm i kësaj figure krimi, d.m.th. nuk janë punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore.

Figurë specifike vepre penale, për shkak të regjimit të posaçëm doganor, në të cilin ndodhen mallrat me të cilët bëhet kontrabanda, siç ishte regjimi i magazinës doganore i 223.853 kg kafe, është edhe ajo e kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal, dispozitë me të cilën, sikurse u tha, me të drejtë është bërë cilësimi ligjor i veprës penale të kryer prej të gjykuarve Jorgaq Murati, Janaq Murati dhe Ariana Heba nga gjykata e apelit.

Kështu që, duke qenë bashkekzekutorë të kësaj kontrabande, përsa i përket konkretizimit të përgjegjësisë penale, vepra e dy grupeve të personave që morën pjesë në këtë veprimtari (me përbërje të grupit të parë janë të gjykuarit Jorgaq, Janaq dhe Arjana, kurse të dytit, të gjykuarit: Astrit, Vladimir, Robert, Sokol, Gëzim, Genci, Salaudin, Edvin dhe Arif) do të cilësohet me dy dispozita të veçanta të pjesës së posaçme të Kodit Penal, përkatësisht me nenet 177 e 175 të tij, në vartësi, përkatësisht, të regjimit të posaçëm doganor të 223.853 kg, kafe me të cilën është realizuar kontrabanda, që përbën një nga elementët përbërës të anës objektive të figurës së krimit që parashikohet nga neni 177 i Kodit Penal dhe të cilësive të veçanta, bartës të të cilave ishte grupi tjetër i personave që e kanë kryer atë, të cilët plotësojnë kërkesën e të qenit subjekt i posaçëm, ekzistenca e të cilit kërkohet për të patur figurën e krimit të parashikuar nga neni 175 i tij.

Figura e krimit të kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal dhe ajo e kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 177 i këtij Kodi, nuk konkurrojnë as me njëra-tjetrën, as edhe me figurat e tjera të krimit të kontrabandës që përfshihen në seksionin e V të nenit të III të Kodit Penal, në të cilin janë përfshirë krimet në fushën e doganave (nenet 171-179 të Kodit Penal).

Në këtë përfundim arrihet duke u nisur, së pari, nga fakti që, ashtu sikurse u përmend, objekti i të gjitha këtyre figurave krimi është i njëjtë (marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave të shtetit) dhe, së dyti, nga fakti që vet ligjvënësi, për arsye praktike, duke dashur të lehtësojë zbatimin sa më të drejtë të tyre në funksion të zhvillimit të një lufte sa më efektive në këtë fushë të kriminalitetit, e ka ndarë kontrabandën në disa figura krimi, të cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund të përbënin paragrafe të veçantë të së njëjtës dispozitë të Pjesës së Posaçme të Kodi Penal.

Figura e krimit nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, nuk konkurron as me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij.

Në këtë përfundim arrihet duke u nisur nga fakti se, anën objektive të figurës së krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, të cilin ligjvënësi, veç të tjerave, e ka shprehur edhe me fjalët: “Kryerja... e veprimeve në kundërshtim me ligjin që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës”, që janë shumë të përgjithshme, në figurën e krimit të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, këtë element përbërës të kësaj figure krimi, e ka konkretizuar, duke e shprehur me fjalët: “Kryerja e kontrabandës...” veprimtari kjo, e cila është e qartë që është në kundërshtim me ligjin dhe me përbushjen e rregullt të detyrës të një kategorie të caktuar personash dhe konkretisht të punonjësve që lidhen me veprimtarinë doganore.

Këta të fundit përbëjnë edhe subjektin e posaçëm të figurës së krimit, të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, në të cilin mund të përfshihet një rreth i kufizuar personash, siç janë punonjësit e doganave ose punonjës të tjerë që kanë lidhje me veprimtarinë doganore dhe jo çdo punonjës i ngarkuar me funksion shtetëror ose me shërbim publik nga të cilat që përbëhet subjekti i figurës së, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga sa u tha më lart, arrihet në përfundimin se figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet në një fushë specifike të veprimtarisë shtetërore, sikurse është ajo e doganave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën.

Pikërisht, duke u nisur nga sa u thanë më lart, në dy paragrafët e mëparshëm të këtij vendimi, është arsyeja që përta i takon cilësimit ligjor të veprës penale të kryer nga i gjykuari Xhetan Qoku, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se vendimi i gjykatës së apelit është i drejtë, i bazuar në ligj e në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Në fuqi, në këtë pjesë të tij, vendimi i gjykatës apelit duhet të lihet edhe përta i takon llojit dhe masës së dënimit, caktuar ndaj të gjykuarit Xhetan.

Vendimi nr.546, datë 18.12.2000 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të lihet në fuqi si përta i takon cilësimit ligjor të veprës dhe llojit e masës së dënimit, edhe për të gjykuarit Flamur Burnazi, Harilla Taçi e Aleks Murati.

Në pjesën që bën fjalë për llojin dhe masën e dënimit, vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit duhet të ndryshohet për të gjykuarit Sokol Alia, Robert Maliqi dhe Edvin Nuku, duke i dënuar ata, respektivisht, me 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj (Sokolin), 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj (Robertin) dhe 2 (dy) vjet (Edvinin) burgim.

Duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat e tjera që janë përmendur në vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe faktin që, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nga kryerja e veprës penale, asaj i ka ikur aktualiteti, bazuar në nenin 59 të Kodit Penal, vendimi i dënimit me burgim për këta të gjykuar do të pezullohet, duke i vënë në provë për 3 (tre) vjet kohe.

Për të njëjtat shkaqe, ekzekutimi i vendimit me burgim do të pezullohet edhe për të gjykuarin Gëzim Piluri, por për 5 (pesë) vjet kohë.

Përta u takon kërkesave të prokurorit, bërë gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, u arrit në përfundimin se ato nuk duhen pranuar, pasi, veç shkaqeve të analizuara me hollësi më lart, përta i takon cilësimit ligjor të veprës për të gjithë të gjykuarit e kësaj çështje, ato, jo vetëm që janë të ndryshme, por edhe në tejkallim të pretendimeve që përmban rekursi i prokurorit të apelit që, krahas rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba e Gëzim Piluri ka shërbyer si bazë për të vënë në lëvizje gjykatën e lartë për gjykimin, prej saj, të kësaj çështjeje penale.

Në lidhje me zgjidhjen e padisë civile në procesin penal, këto Kolegje e çmojnë të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit me të cilin është lënë në fuqi vendimi nr.634, datë 21.10.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka detyruar solidarisht të gjykuarit Jorgaq Murati, Janaq Murati e Arjana Heba (me pasurinë që ata zotërojnë) t'i paguajnë shtetit shumën prej 62.840.960 lekë, shumë që përfaqëson detyrimin doganor të shmangur si rrjedhojë e kontrabandës zhvilluar prej tyre dhe po solidarisht, të gjykuarit Janaq e Aleks Murati (me pasurinë që ata zotërojnë) t'i paguajnë shtetit shumën 680.960 lekë, shumë që përfaqëson detyrimin doganor të shmangur si rrjedhojë e kontrabandës, zhvilluar prej tyre në doganën e Kakavijës (Gjirokastër).

Përta i takon pretendimit të ngritur në rekurs nga të gjykuarit Jorgaq e Janaq Murati, sipas të cilit, në zgjidhjen e padisë civile, gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me nenet 61 e 62 të Kodi të Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se nuk qëndrojnë, pasi këto pretendime nuk gjejnë mbështetje në aktet që ndodhen në dosjen penale që u përket këtyre të gjykuarve.

Përkundrazi, nga shqyrtimi i këtyre akteve, rezulton se kur çështja ishte ende në hetim, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, i është bërë kërkesë organit të prokurorisë për t'u legjitimuar si paditës civil në procesin penal për detyrimet doganore të shmangura si rezultat i mosrieksportimit të 223.853 kg kafe, kërkesë e cila, në zbatim të nenit 61/1 të K.Pr.Penale u pranua me vendim të prokurorit të çështjes, i cili mbas kësaj, krahas kërkesës për gjykimin e kësaj çështjeje penale, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe me kërkesë të veçantë për shqyrtimin, në këtë proces penal, të padisë civile që ishte ngritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ende pa u filluar shqyrtimi gjyqësor, kërkesë, të cilën prokurori e përsëriti, në përputhje me kërkesat e ligjit edhe gjatë seancave që u zhvilluan për shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështjeje penale.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenet 438 dhe 441/"a' e "b" të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.546, datë 18.12.2000, të Gjykatës së Apelit Tiranë për të gjykuarit: Jorgaq Murati, Janaq Murati, Arjana Heba, Xhetan Qoku, Aleks Murati, Flamur Burnazi e Harilla Toci, si përsa i përket cilësimit ligjor të veprës, ashtu edhe llojit të masave të dënimit.

2. Ndryshimin e këtij vendimi për të gjykuarit: Astrit Fajzo, Vladimir Molla, Gëzim Piluri, Genci Gjata (Doraci), Edvin Nuku, Selaudin Uruçi, Arif Murrja, Robert Maliqi dhe Sokol Alia, duke bërë ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës nga shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në kontrabandë, nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal dhe dënimin e tyre: Astrit Fejzo, me 1 (një) vit burgim; Vladimir Molla, me 1 (një) vit burgim; Gëzim Piluri me 3 (tre) vjet burgim; Genci Gjata, me 1 (një) vit burgim; Edvin Nuku me 1 (një) vit burgim; Selaudin Uruçi me kohën e paraburgimit (4 muaj e 15 ditë); Arif Murrja me kohën e paraburgimit; Robert Maliqin me 1 (një) vit burgim dhe Sokol Alia me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim.

I gjykuari Selaudin Uruçi, me vendimin nr.54, datë 30.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ndryshuar me vendimin nr.128, datë 31.3.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është deklaruar fajtor për krimin e parashikuar nga neni 175, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe u dënua me 2 (dy) vjet burgim.

Në zbatim të nenit 56 të Kodit Penal, i gjykuari Selaudin Uruçi, dënohet përfundimisht, me 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 35/1 të Kodit Penal, të gjykuarit: Vladimir Molla, Astrit Fejzo, Gezim Piluri, Genci Gjata, Arif Murrja dhe Selaudin Uruçi dënohen edhe me heqjen e së drejtës për të ushtruar detyra shtetërore, për 3 (tre) vjet kohë.

Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për të gjykuarit: Sokol Alia, Robert Maliqi, Edvin Nuku dhe Gëzim Piluri, duke i vënë në provë, tre të parët (Sokolin, Robertin dhe Edvinin) për 3 (tre) vjet kohë, kurse të gjykuarin Gëzim Piluri, për 5 (pesë) vjet kohë.

3. Lënien në fuqi të vendimit nr.546, datë 18.12.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë për të gjykuarin Edmond Voda.

4. Lënien në fuqi të vendimit në lidhje me padisë civile në procesin penal.

5. Një kopje e këtij vendimi unifikues të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 9, datë 16.1.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anëtar
Perikli Zaharia	“
Spiro Spiro	“
Bashkim Caka	“
Nikoleta Kita	“
Natasha Sheshi	“
Vladimir Metani	“
Valentina Kondili	“
Ylvi Myrtja	“
Vladimir Bineri	“
Metush Saraçi	“
Agron Lamaj	“
Artan Hoxha	“
Irma Bala	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Zamir Poda	“

në seancën gjyqësore të datës 16.1.2002, mori në shqyrtim çështjen civile nr.3 që i përket:

PADITËS: AHMET SHABA, përfaqësuar nga avokat Sokol Parruca.

I PADITUR: KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR, përfaqësuar nga A. Jakova

PERSON I TRETË: PJETËR XHUXHA, përfaqësuar nga avokat N. Fana.

OBJEKTI I PADISË: Shfuqizimi i vendimit nr.96, datë 1.7.1999 të Këshillit Bashkiak, Shkodër.

BAZA LIGJORE: Neni 324/a i Kodi të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr.1321, datë 16.12.1999, ka vendosur: Rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.42, datë 29.2.2000, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.1321, datë 16.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Shkodër.

Kundër vendimit nr.42, datë 29.2.2000, ka paraqitur rekurs paditësi, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Në të dy vendimet është respektuar ose është zbatuar keq ligji.

Kështu, marrëdhëniet juridike që lidhen me kthimin e kompesimin e pronave rregullohen nga ligji nr.7698, datë 15.04.1993. Sipas këtij ligji, pjesa shtetërore e pronës, në bazë të nenit 14 të tij, rregullohet nga ligji 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore “Në nenit 1 dhe 5 saktësohet se e drejta për t'u bërë pronar i jepet vetëm qiramarrësit të banesës shtetërore. Në rastin konkret, përderisa kemi të bëjme me një ligj të veçantë, nuk ka vend të zbatohen kërkesat e parashikuara nga neni 204 i Kodit Civil.

2. Gjykata e Apelit, në mënyrë të gabuar, i referohet nenit 2 të dekretit 1440, datë 4.4.1996, nga ku del e drejta e Këshillit Bashkiak për të vendosur për privatizimin e banesave shtetërore. Kërkesat e nenit 2 nuk mund të merren të shpëputura nga ato të nenit 1 të dekretit.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave del qartë se Këshilli Bashkiak mund të vendosë për banesa dhe jo pjesë banesash që janë në kompetencë të tij, që nuk janë privatizuar deri në 31.12.1995, sipas ligjit 7652, datë 23.12.1992 dhe që nuk janë subjekt i ligjit nr.7698, datë 15.4.1993. Në rastin konkret, pjesa e banesës objekt mosmarrëveshje është bërë tërësisht nga shteti dhe shumë kohë para daljes së ligjit nr.7698, datë 15 prill 1993.

3. Sipas nenit 327/1 të Kodit Procedurës Civile kjo çështje duhet të ishte përfunduar brenda afatit 30 - ditor. Në fakt, është përfunduar shumë kohë më vonë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1556/194, datë 21.6.2000, ka vendosur:

Dërgimin e çështjes për gjykim para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikim të praktikës gjyqësore, me arsyetimin se në rastin konkret konkurrojnë akte ligjore:

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionet e paraqitura nga anëtarët Zamir Poda dhe Bashkim Caka,
pasi dëgjuan përfaqësuesin e paditësit, i cili kërkoi prishjen e vendimeve të Gjykatës së Apelit dhe Shkallës së Parë Shkodër e pranimin e padisë,

pasi dëgjuan përfaqësuesin e të paditurit, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit,

pasi dëgjuan përfaqësuesin e personit të tretë, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit,

VËREJNË:

Vendimi nr.42, datë 29.2.2000 i Gjykatës së Apelit Shkodër është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit. Për pasojë, në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 485/a i Kodi Procedurës Civile, ai duhet të lihet në fuqi.

Është vërtetuar se paditësi Ahmet Shaba, është në pozitën e qerramarësit në banesën nr.1240 në qytetin e Shkodrës.

Me vendimin nr.1441, datë 26 nëntor 1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Shkodër, është vendosur njohja dhe kthimi në favor të personit të tretë Pjetër Xhuxha (ish pronar), e një pjese të banesës në fjalë në masën 39 %. Pjesa e mbetur në masën 61% mbetet në pronësi të shtetit.

Pas kësaj, i padituri Këshilli Bashkiak Shkodër, me vendimin nr.96, datë 1.7.1999, vendos dhënien e të drejtës së privatizimit të pjesës prej 61% në pronësi të shtetit, në favor të personit të tretë Pjetër Xhuxha (bashkëpronar në masën 39%). Këtë vendim, i padituri e motivon me dekretin nr.1440, datë 4.4.1996 dhe në kërkesat e parashikuara në nenin 204 të Kodit Civil.

Paditësi Ahmet Shaba, kërkon sipas objektit të padisë dhe referon kërkesat e ligjit 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore".

Duke e parë në tërësinë e tij gjykimin e kësaj çështjeje në raport me aktet ligjore si më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se drejt kanë vepruar gjykatat, si ajo e Shkallës së Parë, ashtu edhe e Apelit Shkodër që kanë rrëzuar kërkesë - padinë.

Në pamje të parë, eventualisht mendohet se në rastin konkret për zgjidhjen e drejtë të çështjes, konkurrojnë disa akte ligjore dhe konkretisht ligji 7652, datë 23.12.1992 e dekreti nr.1440, datë 4.4.1996. Por në thelb, duke parë, veç sa sipër, edhe ligjin nr.7698, datë 15.4.1993, si dhe kërkesat e nenit 204 të Kodit Civil arrihet në përfundimin e kundërt.

a) Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një pronë që është në bashkëpronësi. Tjetërsimi i pjesës së bashkëpronarit zgjidhet vetëm sipas dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me institutin e bashkëpronësisë.

Sikundër u përmend më lart, vendimi nr.144, datë 26.11.1996 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve, pronën në fjalë e ka trajtuar në bashkëpronësi, respektivisht, në masat ideale 39% në favor të personit të tretë dhe 61% në favor të shtetit. Pra efektivisht kemi të bëjmë me një pronë-banesë, e cila aktualisht është në bashkëpronësi.

Sipas kërkesave të parashtruara në nenin 204 të Kodit Civil, bashkëpronari, në rastin konkret, para se t'ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm, në rastin konkret banesa, një personi që nuk është bashkëpronar, në rastin konkret paditësi, detyrohet të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë, në rastin konkret personin e tretë, nëse dëshirojnë të blejnë, në rastin konkret 61%, me të njëjtat kushte që t'ia shesë personit të tretë”.

Sa sipër, më të drejtë, i padituri Këshilli Bashkiak Shkodër, në cilësinë e bashkëpronarit, shteti, me vendimin nr.96, datë 1.7.1999, ka vendosur të japë të drejtën për privatizim të pjesës shtetërore, në favor të personit të tretë Pjetër Xhuxha, pra bashkëpronarit.

Nga ana tjetër, në të gjithë dispozitat e parashikuara në titullin “III”-të pjesës së dytë të Kodit Civil, ku flitet për bashkëpronësinë, nuk bëhet fjalë në asnjë rast, për zgjidhje të veçanta nga rregulli i përgjithshëm. E njëjta gjë mund të thuhet, siç do ta shohim më poshtë, edhe përsa i përket kërkesave të parashikuara në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 neni 22, kur përsëri kemi referim në Kodin Civil.

b) Ligji nr.7652, datë 23.12.1992 rregullon dhe synon realizimin e privatizimit të banesave shtetërore jo ish-pronë private.

Sipas kërkesave të parashikuara në nenin “1” të ligjit, “ky ligj ka si qëllim të realizojë privatizimin e banesave shtetërore...”. Dhe sipas kërkesave të parashikuara në nenin “21”... banesat shtetërore ish-pronë private nuk privatizohen në bazë të këtij ligji”.

Që këtë dalin dy përfundime apo më saktë kështu, të cilat konkurrojnë veçmas njëra me tjetrën dhe konkretisht:

1. Sipas ligjit në fjalë, që të realizohet privatizimi i një banese, duhet domosdoshmërisht që ajo të jetë vetëm në pronësi të shtetit. Me fjalë të tjera, ligji rregullon privatizimin e të gjithë atyre banesave që janë në pronësi të shtetit, në momentin e hyrjes në fuqi të tij. Në këtë ligj, nuk bëhet fjalë, në asnjë rast, për privatizimin e banesave që janë në bashkëpronësi ndërmjet shtetit dhe një të treti. Për rrjedhojë edhe nuk përcakton ndonjë procedurë të veçantë për realizimin e privatizimit në këto raste.

Në rastin konkret, banesa në fjalë sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, konkretizuar me vendimin nr.1441, datë 26.11.1996 të Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ka kaluar në bashkëpronësi, në pjesë ideale, të shtetit dhe të një individi, ish-pronarit. Pra, banesa nuk është vetëm në pronësi të shtetit.

2. Që të realizohet privatizimi i një banese shtetërore duhet që ajo të mos ketë qenë ish pronë private.

Në rastin konkret, gjithmonë në vijim të analizës sa më sipër, banesa në fjalë sikundër u përmend, ka qenë ish-pronë private dhe i është nënshtruar kërkesave të ligjit 7698, datë 15.4.1993. Për rrjedhojë, banesa objekt mosmarrëveshje nuk mund të trajtohet sipas kërkesave të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992.

Përsa i përket përcaktimit që bëhet në kërkesat e nenit 22 të ligjit, se marrëdhëniet e bashkëpronësisë midis pronarëve rregullohen me ligj të veçantë, moment ku kërkon të referohet paditësi, një gjë e tillë duhet parë në vazhdimësi dhe në lidhje me kërkesat e parashikuara në nenin 21 të ligjit.

Efektivisht, në rastin tonë kemi të bëjmë me një banesë që nuk ka qenë, nuk është dhe nuk mund të jetë objekt i ligjit të përmendur, pikërisht për cilësitë e saj, të cilat u theksuan më lart (sipas nenit 21-banesat shtetërore ish - pronë private nuk privatizohen në bazë të këtij ligji).

Megjithatë, përcaktimi që bën neni 22, ka të bëjë me marrëdhëniet e bashkëpronësisë, që eventualisht krijohen ndërmjet 640,661,662,639 individëve që kanë realizuar privatizimin e banesës shtetërore në kushtet që përcakton ligji nr.7652, datë 23.12.1992.

Neni 22 i ligjit në fjalë është një dispozitë e bardhë (blanket). Duke qenë e tillë, ajo më pas, i referohet kërkesave të ligjit nr.7688, datë 13 mars 1993 “Për bashkëpronësinë në banesa”, i cili nga ana e tij me hyrjen në fuqi të Kodit Civil më 1 nëntor 1994 është bërë pjesë e këtij Kodi (shiko nenin 1167 të Kodit Civil). Për rrjedhojë, kur thuhet se “marrëdhëniet e bashkëpronësisë midis pronarëve rregullohen me ligj të veçantë”, nënkuptohen pikërisht dispozitat që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë, sipas Kodit Civil.

c) Dekreti nr.1440, datë 4.4.1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të pa privatizuara”, duke qenë vazhdim i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, rregullon privatizimin e banesave shtetërore që aktualisht nuk janë privatizuar, si dhe përcakton organin shtetëror (bashki-komuna), i cili do të administrojë dhe realizojë privatizimin e tyre.

Në vijim, përsa u përmenden, ky akt, në një farë mënyre, është vazhdim i rregullimit ligjor për privatizimin e banesave shtetërore, që ka bërë ligji i cituar nr.7652, datë 23.12.1992.

Ai përcakton organet e pushtetit lokal, sipas vendodhjes së banesave shtetërore, si dhe rregullon konkretisht privatizimin e atyre banesave, që nuk janë privatizuar deri në datën 31.12.1995 dhe nuk janë subjekte të ligjit “Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish - pronarëve”. Praktiki, në analizë qëndrojnë përgjithësisht të gjitha argumentet e sjella më lart, kur u trajtua ligji nr.7652, datë 23.12.1992.

Megjithatë, duke parë këto përfundime, arrihet në konkluzionin se referimi i pjesshëm, që i padituri-Këshilli Bashkiak Shkodër ka bërë kur ka nxjerrë vendimin nr.96, datë 1 korrik 1999, është i gabuar. Themi referim i pjesshëm, mbasi ky vendim, në të njëjtën kohë ka edhe një referim të saktë ligjor, siç janë kërkesat e nenit 204 të Kodit Civil. Përmendja si bazë ligjore edhe e dekretit nr.1440, datë 4.4.1996, nuk cenon dhe nuk mund të cenojë thelbin e zgjidhjes së problemit, ligjshmërinë e nxjerrjes së vendimit. Në vijim të analizës së bërë, kjo bazë ligjore e gabuar, efektivisht, mbetet pa asnjë funksion dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike, që motivojnë cenimin e vendimit.

Pavarësisht sa sipër, me të drejtë i padituri-Këshilli Bashkiak Shkodër, duke qenë administrator i banesës (pjesë shtetërore), ka vendosur që pjesën shtetërore, në përputhje me kërkesat ligjore që rregullojnë bashkëpronësinë, t'ia shesë pikërisht bashkëpronarit, në rastin konkret personit të tretë Pjetër Xhuxha.

Në këtë vendim të Këshillit Bashkiak, gjithashtu, është zgjidhur në të njëjtën kohë edhe pozicioni i paditësit Ahmet Shaba, i cili gëzonte statusin e të pastrehit, duke mbetur në cilësinë e qiramarrësit, në kushte qiraje të përcaktuara për banesat ish - pronë private, derisa shteti të zgjidhte problemin e strehimit.

Përsa i përket pretendimeve të ngritura në rekursin e paraqitur nga ana e paditësit Ahmet Shaba, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se ato nuk janë të tilla që të motivojnë ligjërisht cenimin e vendimit nr.42, datë 29.2.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Analiza e bërë sa më sipër, vlen për t'ju dhënë përgjigje këtyre pretendimeve.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të kërkesave të nenit 141/2 të Kushtetutës, nenit 17/a të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Lënen në fuqi të vendimit nr.42, datë 29.2.2000 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Ky vendim, unifikuës për praktikën gjyqësore, të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Siç rezulton nga materialet e dosjes gjyqësore, me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Shkodrës, është vendosur njohja e pronësisë në masën 39% në favor të personit të tretë Pjetër Xhuxha në një banesë në këtë qytet, në të cilën janë bërë shtesa nga ana e shtetit në masën 61 %. Në këtë banesë është në pozitën e qeramarrësit paditësi Ahmet Shaba.

Mbas kësaj, nga ana e Këshillit Bashkiak Shkodër është vendosur dhënia e të drejtës së privatizimit të pjesës prej 61% në pronësi të shtetit, në favor të personit të tretë Pjetër Xhuxha, bashkëpronar në masën prej 39 %. Nga ana e këtij Këshilli, vendimi është bazuar në nenin 204 të Kodit Civil dhe në dekretin nr.1440, datë 4.4.1996.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke unifikuar praktikën gjyqësore, kanë mbajtur qëndrimin se vendimi i Këshillit Bashkiak është i bazuar në ligj, për arsye se në rastin konkret prona është në bashkëpronësi dhe tjetërsimi i pjesës së bashkëpronarit bëhet duke respektuar dispozitat mbi bashkëpronësinë.

Këtë qëndrim të shumicës e konsiderojmë të gabuar për këto shkaqe:

1. Banesa objekt i këtij gjykimi është trajtuar në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 që rregullon njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve të marra padrejtësisht mbas 29 nëntorit 1944. Në nenin 13 të këtij ligji trajtohen rastet kur në objektin ish-pronë private janë kryer nga ana e shtetit apo nga ana e personit blerës të objektit ndryshime në strukturë, shtesa anësore dhe shtesa kati. Kur vlera e shpenzimeve të kryera është mbi 50 % të vlerës së objektit (si në rastin në gjykim) ky i fundit mbetet në bashkëpronësi.

Nisur nga qëllimi në tërësi i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave dhe në veçanti edhe nga neni 13 i cituar, rezulton se ligjvënësi në këto raste ka patur si qëllim që të kthejë objektin ish - pronarit pa kundërshtim në rastet kur vlera e shpenzimeve përbën deri në 20 % të vlerës së objektit, të kalojë në pronësi të ish- pronarit objektin kur vlefata e shpenzimeve përbën mbi 20 % deri në 50 % (pasi të jetë shlyer kundërvlefata dhe kur vlefata e shpenzimeve të kryera është mbi 50 % të vlerës së objektit, ky i fundit mbetet në bashkëpronësi. Kjo bashkëpronësi mund të krijohet me subjektin që ka bërë shtesat apo ndryshimet, pra shtetin ose personin blerës të ish - pronës së pronarit.

Në rast se për pronat e ish - pronarëve në të cilat janë bërë në vite ndryshime strukturore apo shtesa, ligjvënësi do kishte si qëllim që të përcaktonte për ish-pronarët të drejta më të mëdha se ato që parashikon neni 13 i ligjit, atëherë do të parashikonte edhe për këto raste të drejtën e parablerjes që parashikon në nenin 21 të tij. Ligjvënësi e kishte parasysh faktin se shteti mbetet bashkëpronar me ish-pronarin dhe në asnjë dispozitë të këtij ligji apo të ligjeve të mëvonëshme nuk parashikoj detyrimin e tij që këtë fond banese ta përdorte në favor të ish-pronarëve në zbatim të të drejtës së parablerjes që rrjedh nga neni 204 i Kodit Civil.

Në këtë aspekt, interpretimi i bërë nga shumica nuk përputhet me qëllimin e ligjit, i cili njihet për ish - pronarin bashkëpronësinë, kur vlera e shpenzimeve është mbi 50 %, ndërsa qëndrimi i mbajtur në këtë vendim nga shumica në fakt “kthen” pronën ish - pronarëve. Nga ana e shumicës i është dhënë përparësi ligjit që bën rregullimin e përgjithshëm (nenin 204 të Kodit Civil) në krahasim me ligjin që bën rregullimin e posaçëm, specifik (nenin 13 i ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave), duke mos pasur parasysh parimin e njohur mbi përparësinë e ligjit specifik.

2) I gabuar për mendimin tonë është edhe interpretimi që shumica i bën ligjit nr.7562, datë 23.12.1992 “ Për privatizimin e banesave shtetërore.” dhe dekretin nr.1440, datë 4.4.1996 “ Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara.”

Kështu, duke pohuar se “që të realizohet privatizimi i një banese duhet domosdoshmërisht që ajo të jetë vetëm në pronësi të shtetit”, shumica konkludon se ligji nuk parashikon rastet kur banesat janë në bashkëpronësi të shtetit dhe një të tretë dhe indirekt sipas këtij arsytimi, në rastin konkret nuk mund të aplikohet ligji nr.7652, datë 23.12.1992.

Ligji për privatizimin e banesave shtetërore, që në nenin 1 të tij ka parashikuar si qëllim të tij privatizimin e banesave që janë në pronësi të shtetit. Fakti që shteti kishte në pronësi 61 % të banesës dhe ish-pronari 39 % të saj nuk përbën asnjë ndalim ligjor për shtetin që të privatizojë pjesën e tij të pronësisë në favor të qiramarrësit të banesës shtetërore, që është gjithashtu një synim që kërkohet të arrihet nëpërmjet këtij ligji.

I gabuar është, gjithashtu, edhe interpretimi që i bëhet nga shumica dekretit 1440, datë 4.4.1996 dhe nenin 21 të ligjit nr.6752, datë 23.12.1992, sipas të cilëve “banesat shtetërore ish - prone private nuk privatizohen në bazë të këtij ligji.”

Edhe në këtë drejtim, absolutizohet pjesa ideale që i takon ish-pronarit, duke u konsideruar “banesa pronë private” dhe lihet mënjane fakti që kjo ndërtesë nuk është krejtësisht e tillë dhe se pjesën më të madhe të pronësisë së saj e ka shteti, ashtu siç absolutizohet edhe interpretimi i nenit 1, duke u argumentuar se banesa duhet të jetë vetëm në pronësi të shtetit.

Nga tërësia e arsytimeve të bëra më sipër arrijmë në përfundimin se ish - pronarit, duke iu njohur bashkëpronësia në masën 39 % të banesës, i janë dhënë të gjitha të drejtat që parashikon ligji nr.7698, datë 15.4.1993 dhe Këshilli Bashkiak nuk duhet të bënte privatizimin e pjesës në pronësi të vet në favor të ish pronarit, por në zbatim të ligjit dhe të dekretit për privatizimin e banesave shtetërore të bënte privatizimin e kësaj pjese në favor të qiramarrësit të banesës.

Kryesues: Th. Kondi

Anëtarë: P. Zaharia, S. Spiro, N. Sheshi, V. Metani, V. Kondili, M. Saraçi, B. Caka

VENDIM
Nr. 22, datë 13.3.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të formuar prej nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anëtar
Perikli Zaharia	“
Bashkim Caka	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Agron Lamaj	“
Metush Saraçi	“
Natasha Sheshi	“
Nikoleta Kita	“
Artan Hoxha	“
Spiro Spiro	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Bineri	“
Vladimir Metani	“
Ylvi Myrtja	“
Zamir Poda	“

morën në shqyrtim në seancën gjyqësore të datës 13.3.2002 çështjen civile që i përket pjesëmarrësve në proçes:

PADITËS: Edlira Bedri TURKU, lindur dhe banuese në Tiranë, në mungesë.

I PADITUR: Milo Sotir KUNESHKA, lindur dhe banues në Tiranë i përfaqësuar në gjykim nga avokat Z. B. RUSI.

Gabriela KUNESHKA, banuese në Tiranë, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Pjesëtim i pasurisë së palujatshme, në bazë të nenit 207 të Kodit Civil dhe 370 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin dt. 23.2.2000 (faza e parë e pjestimit), ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë dhe lejimin e pjestimit të një apartamenti dhe pasurisë së luajtshme, duke u takuar secilit nga 1/3 pjesë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 751, datë 13.7.2000, ka vendosur:
Ndryshimin e vendimit të mësipërm duke lejuar edhe pjestimin e një shtese të apartamentit nga 1/3 pjesë secili.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 1317, dt. 24.10.2001, ka vendosur:
dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim unifikimin e praktikës gjyqësore dhe konkretisht që t'i jepet përgjigje pyetjeve të mëposhtme:

1. A do të përfshihet në pjestimin e pasurisë së përbashkët ndërtimi i bërë pa lejen e organit kompetent shtetëror?
2. A ligjërohet në këtë rast, nëpërmjet vendimit gjyqësor, fitimi i pronësisë?
3. A lejohet organi administrativ të ndërhyjë mbi këtë ndërtim të paligjshëm pas dhënies së vendimit gjyqësor?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relativimin e anëtarëve Agron Lamaj dhe Vladimir Bineri,
dëgjuan përfaqësuesin e të paditurit Kuneshka, Av. Rusi, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, si dhe shqyrtuan dhe biseduan në tërësi çështjen,

VËREJNË:

Se rekursi i paraqitur është i drejtë dhe i ligjshëm dhe, si i tillë, duhet të pranohet dhe vendimi i gjykatës së apelit për zbatim të gabuar të ligjit (neni 472 § a të Kodit të Procedurës Civile) duhet të prishet, duke u lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit, ka rezultuar se pjesëmarrësit në proces kanë qenë bashkëshort, ndërsa e paditura Gabriela, nëna e të paditurit Milo. Ato kanë në bashkëpronësi një apartament banimi, pronë e cila është edhe e regjistruar në regjistrin e pasurive të palujtshme, dhe ngjitur me apartamentin ekzistues, pa lejen e organit kompetent shtetëror, kanë lejuar edhe ndërtimin e një shtese, pjesëtimin e së cilës e kërkon paditësja gjyqësisht.

Meqenëse ky ndërtim (shtesa) është i paligjshëm, d.m.t.h. pa leje të organit kompetent, megjithë kërkesën e paditëses nuk është bërë i mundur regjistrimi i tij në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Palujtshme.

Në kërkesë - padinë e saj paditësja i është referuar neneve 207 të Kodit Civil (pjesëtimi i pasurisë së palujtshme) dhe nenit 370 të Kodit të Procedurës Civile (fazat e gjykimit).

Në bazë të nenit 370 të Kodit të Procedurës Civile "Gjykimi për pjesëtimin e sendeve në bashkëpronësi dhe në trashëgim, në fazën e parë të tij ka për qëllim të hetojë e të përcaktojë të drejtën e bashkëpronësisë së ndërgjyqësve, pjesët takuese të tyre, si edhe sendet që do të pjesëtohen. Pasi të ketë marrë provat e nevojshme, gjykata, me vendim të ndërmjetëm, lejon pjestimin dhe përcakton rrethin e bashkëpjestarëve, sendet që do të pjesëtohen, si edhe pjesët takuese të secilit prej tyre".

Kuptimin e bashkëpronësisë e jep neni 199 § 1 i Kodi Civil i cili përcakton se "ka bashkëpronësi kur një ose disa sende dhe të drejta të tjera reale u përkasin bashkërisht dy ose më shumë personave". Pra paditësja duhet të provojë para gjykatës pretendimin e saj se ajo dhe pjesëmarrësit e tjerë në proces kanë të drejta pronësie mbi sendet që pretendohen të ndahen.

Kuptimi i pronësisë është i lidhur gjithnjë me përcaktimin ligjor të saj dhe kjo del edhe nga përmbajtja e nenit 149 të Kodit Civil "pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji". Kjo e drejtë (e pronësisë) fitohet sipas mënyrave të caktuara në Kodin Civil dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Edhe në këtë rast, paditësja nuk ka paraqitur asnjë provë që të provojë pretendimin e saj të pronësisë ose të kalimit të sendit në bashkëpronësi. Veç kësaj, siç u theksua edhe me lart, fakti i ndërtimit të shtesës nuk figuron të jetë regjistruar në regjistrin e pasurive të palujtshme.

Në këto rrethana, përderisa paditësja nuk provon të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendin objekt gjykimi nuk legjitimohet të kërkojë pjesëtimin e tij.

Në bazë të nenit 6 të Kodit të Procedurës Civile “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”.

Paditësia, me kërkesë-padinë e paraqitur, ka kërkuar pjesëtimin e shtesës së ndërtimit si objekt më vete, dhe jo të pjesëve të saj përbërëse (materialeve ndërtimore). Kjo është e drejta e saj dhe këtë të drejtë ajo e ka përqendruar në objektin e kërkesë-padisë. Por, nga ana tjetër ajo ka edhe detyrimin të provojë pretendimet e saj d.m.th. pronësinë ose bashkëpronësinë mbi këtë objekt, të cilën ajo, siç u arsyetua edhe më lart, nuk ka mundur ta realizojë, dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë i ka rrezuar padinë.

Por në analizën e faktit të mësipërm duhet të mbahet parasysh edhe përmbajtja e nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Në bazë të këtij neni, “padia ngrihet vetëm kur personi ka interes të ligjshëm në njohjen ose rrëzimin e një pretendimi”.

Në këtë kuptim, duhet që paditësja me ngritjen e padisë të provojë se ka një interes të tillë. Në rastin konkret, interesi nuk mund t’i referohet anës procedurale (pjesëtimin), por objektin mbi të cilin do të realizohet pjesëtimi, pra vetë ndërtimit. Meqenëse ky ndërtim është i paligjshëm nuk mundet të pranohet se nga ai burojnë interesa të ligjshme. Nga një veprim i kundërligjshëm nuk mundet të pretendohet se vijnë pasoja të ligjshme. Një kuptim i tillë buron edhe nga neni 31§ 2 “Padia i jep të drejtë palës tjetër kundërshtare për të diskutuar mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi”. Në këtë kuptim, nuk mundet të pranohet se nga një ndërtim i tillë burojnë të drejta bashkëpronësie përse kohë që e drejta e pronësisë nuk është fituar në mënyrë të ligjshme. Gjykata është organ që, në vendimin e saj, bazohet vetëm në ligj, pra që në funksion të ligjit shqyrton veprimin e njëjës apo tjetrës palë.

Në rrethanat e përmendura më lart, Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë, me qëllim të përcaktimit të një qëndrimi unifikues për të shmangur në këtë mënyrë qëndrime të ndryshme e të kundërta me njëri – tjetrin, arrin në bindjen se:

shtesa ose ndërtimi, i cili është realizuar në kundërshtim me normat në fuqi dhe nuk është regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme nuk mundet të jetë objekt i pjesëtimin gjyqësor dhe personi i interesuar për arsye se nuk përfaqëson interes të ligjshëm në këtë rast nuk mundet të legjitimohet në ngritjen e padisë për pjesëtimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje edhe të nenit 485§ b të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr. 751, datë 13.07.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (faza e parë e pjesëtimin) datë 23.2.2000.
2. Një kopje e këtij vendimi unifikues dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Palët ndërgjyqëse, ish-bashkëshortë ndërmjet tyre, janë bashkëpronarë të një apartamenti banimi prej 3 dhoma + 1 kuzhinë, të cilën edhe e kanë të regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme. Bashkëngjitur me këtë pronë, me kontribut të përbashkët, palët kanë ndërtuar një shtesë 3 - katëshe pa leje ndërtimi, e cila nuk është regjistruar.

Paditësja ka kërkuar pjesëtimin e apartamentit 3 + 1 të sendeve të luajtshme (televizorë, lavatriçe, frigoriferë, dhomë gjumi, etj.), si dhe të ndërtimit të kryer pa leje ndërtimi.

Gjykata e rrethit, me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit, nuk ka pranuar pjesëtimin e ndërtimit për shkak se nuk është kryer sipas dispozitave ligjore me lejen përkatëse.

Gjykata e apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke lejuar pjestimin edhe të shtesës pa leje ndërtimi.

Ndryshe nga shumica, kemi mendimin se gjykata e apelit ka vepruar drejt, duke lejuar edhe pjestimin e ndërtimit të kryer pa leje të rregullt ndërtimi.

Pavarësisht se ndërtimi është bërë duke mos marrë lejen përkatëse administrative, gjykata e rrethit duhet të lejonte pjesëtimin, sepse ai përbën pronësi të përbashkët të bashkëshortëve në lidhje me sendet që kanë shërbyer për këtë ndërtim, si dyer, dritare, instalime elektrike, komplekset hidro-sanitare, tullat e të tjera. Duke mos u pranuar pjesëtimi i tyre, shmanget nga ana e gjykatës zgjidhja e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, duke u disponuar sendi i përbashkët në mënyrë të padrejtë nga njëri prej bashkëshortëve dhe, si rrjedhojë, krijohen konflikte sociale, të cilat vështirësojnë zgjidhjen ligjore të konfliktit. Për më tepër, kur është fakt i njohur që vitet e fundit në vendin tonë janë bërë shumë ndërtime pa leje, madje dhe në zona masive.

Çështja që duhet të zgjidhte gjykata qëndronte në përcaktimin e natyrës juridike të sendit, pra nëse ndërtimi do t'i nënshtronte pjesëtimit, duke u konsideruar pasuri e paluajtshme dhe, për rrjedhojë, të zbatoheshin rregullat procedurale për pjesëtimin e sendeve me natyrë të tillë.

Në rastin në shqyrtim, banesa e bashkëshortëve e fituar nga privatizimi duhet të trajtohej në mënyrë të ndryshme nga ndërtimi i kryer në kundërshtim me rregullat. Për të parën duhet të zbatohen rregullat për pjesëtimin e sendit të paluajtshëm, ndërsa për ndërtimin pa leje duhen aplikuar rregullat për pjesëtimin e sendit të luajtshëm. Edhe në kërkesë - padi është saktësuar se ndërtimi është kryer pa leje dhe se kërkohet edhe pjesëtimi i tij, megjithëse nuk është saktësuar se kërkohet pjesëtimi si send i luajtshëm. Në këto rrethana, duke pranuar se ndërtimin pa leje do të lejohej të pjesëtohej si send i luajtshëm, gjykata nuk tejkalonte as kërkimin e bërë nga paditësi në kërkesë - padinë e ngritur.

Shumica, duke nënvizuar parimin e procesit civil se gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet, krijon përshtypjen se thelbi i zgjidhjes së mosmarrëveshjes qëndron në problemin procedural, nëse paditësja ka kërkuar pjesëtimin e ndërtimit pa leje, duke e konsideruar atë send të paluajtshëm ose jo si të tillë. Shumica mban qëndrimin se “Paditësja me kërkesë-padinë e paraqitur ka kërkuar pjestimin e shtesës së ndërtimit si objekt më vete dhe jo të pjesëve të saj përbërëse (materiale ndërtimore). Kjo është e drejtë e saj dhe këtë të drejtë ajo e ka përqëndruar në objektin e kërkesë - padisë.” Me këtë arsyetim indirekt edhe shumica duket sikur pranon që ndërtimi pa leje mund t'i nënshtronte pjesëtimit lidhur me pjesët përbërëse të tij.

Meqenëse vendimi është unifikues, këto qëndrime ekuivoke duhet të ishin mënjanoar, çka është edhe shkak i votimit nga ana jonë kundër vendimit të marrë nga shumica.

Është e natyrshme se ndërtimi i bërë pa leje, në kuptimin formal, për shkak të lidhjes së qëndrueshme që ka me tokën, konsiderohet si send i paluajtshëm, por ai nuk mund të përmbushë natyrën juridike të një sendi të këtij lloji, për shkak të ndalimeve ligjore për regjistrimin në Regjistrat e Pasurisë së Paluajtshme, të cilat rrjedhin nga paligjshmëria e ndërtimit të bërë.

Pavarësisht nga kjo “ndërtimi pa leje është send”, sepse materialet që kanë shërbyer për ndërtimin e tij, përbëjnë objekt pronësie dhe prandaj ato ngelen sende të pjestueshme si sende në bashkëpronësi.

Në rrethanat e përmendura me qëllim për të shmangur kundërshtitë e praktikave gjyqësore arrijmë në përfundimin se:

Shtesa ose ndërtimi që është realizuar në kundërshtim me ligjin pa lejen përkatëse administrative dhe që nuk është regjistruar në regjistrin e Pasurive të Paluajtshme nuk mund të jetë objekt i pjesëtimit gjyqësor si send i tillë, por personi i interesuar legjitimohet që të kërkojë pjesëtimin e materialeve që kanë shërbyer për kryerjen e shtesës apo të ndërtimit.

VENDIM
Nr. 23, datë 1.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	“
Spiro Spiro	“
Ylvi Myrtja	“
Agron Lamaj	“
Bashkim Caka	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Metani	“
Vladimir Bineri	“
Metush Saraci	“
Zamir Poda	“
Natasha Sheshi	“
Nikoleta Kita	“
Artan Hoxha	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Irma Bala	“

në seancën gjyqësore të datës 13.3.2002 dhe datës 1.4.2002 morën në shqyrtim çështjen civile nr.17, me palë:

PADITËS:

1. Fatime BRASHA, përfaqësuar nga avokat Ardian Nuni.
2. Hatixhe SESERI, në mungesë.
3. Sanie ELEZI, në mungesë.
4. Hava LEKA, në mungesë.
5. Mimoza BEJA, në mungesë.

I PADITUR: Halil BARDHI, përfaqësuar nga avokat Gëzim Lama.

OBJEKTI I PADISË: Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.2670/954, datë 5.8.1995, duke urdhëruar Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme të bëjë çregjistrimin përkatës.

BAZA LIGJORE: Nenet 92 dhe 762 të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.732, datë 23.6.2000, ka vendosur:

Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë së paditësave Fatime Brasha etj., duke konstatuar pjesërisht të pavlefshme kontratën e dhurimit nr.2670/954, datë 05.8.1995, regjistruar në regjistrin hipotekor nr.6904, datë 31.8.1995, vetëm për sipërfaqen 1515 m² e blerë nga paditësat me kontratën e shitblerjes nr.6863/5171, datë 9.12.1996, pasi i padituri Halil Bardhi nuk ka marrë pjesë në këtë kontratë shitblerje dhe kjo kontratë nuk është realizuar me të drejtën e parablerjes si e drejte reale e ish - pronarit.

Urdhërohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të bëjë regjistrimin përkatës.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.425, datë 7.9.2000, ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr.732, datë 23.6.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
Rrëzimin e padisë së paditësve, si të pabazuar në ligj e në prova.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs paditësit, të cilët parashtrojnë këto shkaqe për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim.

Kontrata e dhurimit ishte e pavlefshme, sepse me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave na ishte njohur e drejta e pronësisë dhe nuk na ishte kthyer një pronë konkrete. Në atë kohë gëzonin të drejtën e parablerjes dhe asnjë të drejtë tjetër.

Gjykata e apelit interpreton gabim nenin 162 të Kodit Civil, pasi në bazë të këtij neni, më parë duhet fituar sendi, ndërsa në rastin konkret, ne nuk kishim fituar në pronësi as objektin dhe as truallin.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2855, datë 18.10.1995, ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga njëri prej bashkëtrashëgimtarëve, pikërisht me arsyetimin se na është njohur vetëm e drejta e pronësisë dhe se nuk kishim fituar pronësinë.

Pra, janë mbajtur dy qëndrime të ndryshme nga gjykata.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e anëtarëve Ylvi Myrtja e Spiro Spiro, përfaqëuesin e paditëses Fatime Brasha, avokat Ardian Nuni, i cili kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, përfaqësuesin e të paditurit, avokat Gëzim Lama, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Me vendimin nr.434, datë 18.04.1994 të Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, trashëgimtarëve të Ismail Bardhit: Sofie Bardhi, Gani Bardhi, Fatime Brasha, Hatixhe Sesei, Ibrahim Bardhi, Hava Leka e Sanie Elezi u është njohur e drejta e pronësisë mbi një sipërfaqe trualli prej 3177m², duke iu njohur e drejta e parablerjes për objektin (shtypshkronjë) të ndërtuar mbi sipërfaqen 1140 m² (342 m² sipërfaqe ndërtimore + 798 m² sipërfaqe funksionale) dhe duke u kompensuar për sipërfaqen 2037m², sipas nenit 16 pika "a" të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Me vendimin nr.3025, datë 7.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës është bërë ndryshimi i vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në pjesën e kompensimit të sipërfaqes, jo sipas nenit 16/a të ligjit nr.7698, datë 15.04.1993, por sipas nenit 16/b të këtij ligji, për kompensimin në natyrë në territorin e qendrës së banuar.

Me kontratën e dhurimit datë 5.8.1995, Sofie Bardhi, si një nga trashëgimtarët e Ismail Bardhit, i ka dhuruar pjesën e vet (1/7) të pasurisë trashëgimore të paditurit Halil Bardhi. "Jam pronare e 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore ... të një sipërfaqe toke të përbërë nga 3177m² ... ku ndodhet e ndërtuar shtypshkronja, pallate, lulishte ... pjesën time të pandarë ia dhuroj nipit tim ..." (cituat nga kontrata e dhurimit).

Me kontratën e shitjes datë 23.10.1995 paditësit kanë blerë nga shitësat Teuta Resuli etj., një pjesë të objekteve të shtypshkronjës që ndodhen në sipërfaqen e truallit të trashëgimlënësit të tyre (ish-pronarit Ismail Bardhi).

Me kontratën e shitjes datë 9.12.1996 kanë blerë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Privatizimit (AKP) Dega Durrës edhe sipërfaqen e truallit nën objekt, së bashku me sipërfaqen funksionale.

Pala paditëse ka kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit datë 5.8.1995, me pretendimin se:

- Kontrata e dhurimit bie në kundërshtim me nenin 762 të Kodit Civil.
- Dhuruesja nuk ka qenë pronare në momentin e dhurimit, pasi vendimi i Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave u ka njohur atyre pronësinë, e truallit, por nuk ua ka kthyer atë.
- Me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave kemi fituar vetëm të drejtën e parablerjes.

Pra, objekt gjykimi është kontrata e dhurimit.

Dhuresja ka dhuruar pjesën e saj të pandarë të pronësisë, pasi Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave i ka njohur asaj dhe trashëgimtarëve të tjerë të ish - pronarit të drejtën e parablerjes për objektin dhe të drejtën e kompensimit për pjesën tjetër të sipërfaqes së truallit.

Gjykatat e të dy shkallëve kanë vendosur në mënyrën e përshkruar më lart.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1323, datë 12.12.2001, ka vendosur: Dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore. Kolegjeve të Bashkuara u shtrohen për zgjidhje këto probleme:

Së pari, dhurohet sendi apo edhe e drejta reale?

Në qoftë se konkludohet se dhurohen edhe të drejta reale, atëherë e drejta e parablerjes, sipas nenit 21 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve" do të konsiderohet e drejtë reale dhe a është nga ato që mund të dhurohet.

Së dyti, me kontratën e shitjes, sipas nenit 705 të Kodit Civil, kalohet pronësia e një sendi ose kalimi i një të drejte tjetër.

Me kontratën e dhurimit, sipas nenit 761 të Kodit Civil, kalohet në pronësi pa shpërblim një send i caktuar ose një e drejtë reale.

Lind pyetja:

A është i njëjtë kuptimi i kalimit të një të drejte sipas nenit 705 të Kodit Civil me atë të kalimit të një të drejte reale, sipas nenit 761 të Kodit Civil?

A përfshihet në konceptin e pasurisë së dhuruesit e drejta e parablerjes sipas nenit 21 të ligjit të mësipërm?

Së treti, në konceptin e deritanishëm kontrata e dhurimit është konsideruar si kontratë reale, që quhet e lidhur me çastin e dorëzimit të sendit.

Rasti i vetëm që kontrata e dhurimit mund të konsiderohet jo reale, por konsensuale, është kur, njëri nga bashkëpronarët i dhuron tjetrit pjesën ideale të sendit në bashkëpronësi.

A do të zgjerohet ky koncept edhe në rastin e dhurimit të një të drejte tjetër reale në kuptimin e nenit 761 të Kodit Civil, pra në rastin e të drejtës së parablerjes?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se vendimi nr.42, datë 7.9.2000 i Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin është rrëzuar padia e paditësave Fatime Brasha etj., për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.2670/954 datë 5.8.1995, është i bazuar në ligj, prandaj duhet të lihet në fuqi.

Me vendimin nr.434, datë 18.4.1994 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-pronarëve trashëgimtares Sofije Bardhi i është njohur lindja e të drejtës së pronësisë në 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore të rrjedhur nga trashëgimlënësi i saj, i ndjeri Bardhi. Njohja e kësaj të drejte konsiderohet se i fillon efektet e saj në momentin e çeljes së trashëgimisë, që është momenti i vdekjes së trashëgimlënësit. Në konceptin e pasurisë trashëgimore, në kuptim të dispozitave mbi trashëgiminë (nenet 332, 356 të Kodit Civil) përfshihen sende, të drejta reale dhe kredi, por kjo pasuri mund të rëndohet edhe nga pasivët (borxhet) e trashëgimlënësit. Pra, pasuria e trashëgimlënësit nuk përfshin vetëm të drejtën e pronësisë mbi sende të caktuara të trashëgimlënësit, por tërësinë e të drejtave reale e të detyrimeve që zotëronte apo mbante ai në gjallërinë e tij.

Është e vërtetë që trashëgimtarëve u është njohur e drejta e pronësisë së trashëgimlënësit të tyre në sipërfaqen e truallit prej 3177 m², por atyre nuk u është kthyer kjo pronë (restitutio in integrum). Ata, në lidhje me të e për shkak të saj, kanë fituar në masën 1/7 pjesë secili të drejtën e parablerjes së objekteve të ndodhura mbi të, e cila, në rast se bëhet e mundur të realizohet pas ushtrimit të saj u kthen automatikisht dhe pronësimin mbi truallin dhe/ose të drejtën e kompensimit të truallit të zënë në njërin nga mënyrat e parashikuara në nenin 16 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993. E drejta e parablerjes, e parashikuar në nenin 21 të ligjit të mësipërm, është një e drejtë e mundshme për t'u realizuar në potencë për ato objekte që janë ndërtuar nga shteti në tokën e ish-pronarit e që vazhdojnë të jenë në pronësi të tij në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji (d.m.th. që nuk rezultojnë të kenë kaluar në mënyrë të ligjshme në pronësi të tjerëve) dhe që shteti vendos t'i privatizojë. Ndërsa e drejta e kompensimit është një e drejtë e fituar që me daljen e vendimit të kompensimit të pronave, sepse përbën marrjen përsipër nga shteti të një detyrimi të përcaktuar për ta realizuar atë në një kohë të ardhme.

Por, e drejta e parablerjes e trashëgimtares Sofije Bardhi nuk mund të prekë të drejtat e fituara me privatizim nga persona të tjerë para daljes së ligjit nr.7698 datë 15.4.1993 dhe as transferimet e mëvonshme të këtyre të drejtave. Në vartësi të sa më lart, në masën e ngushtimit apo pamundësisë së realizimit të së drejtës së parablerjes, mund të zmadhohet sipërfaqja e truallit të kompensueshëm në favor të trashëgimtarëve të ish-pronarit.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm arrihet në interpretimin e saktë të përmbajtjes së kontratës objekt padie. Në kontratë dhuruesja deklaroi se është pronare e 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore të rrjedhur nga trashëgimlënësi Ismail Bardhi dhe se këtë pasuri, të rregjistruar edhe në regjistrin e hipotekave, ia dhuron pranuesit të dhurimit Halil Bardhi. Dhuruesja nuk ishte pronare e 1/7 së truallit prej 3177 m², ajo nuk e zotëronte këtë të drejtë. Për rrjedhojë, nuk mund të dispononte dhe, në fakt, nuk e ka disponuar atë. Ajo ka disponuar vetëm të drejtat e tjera pasurore të fituara në mënyrë të prejardhur nga e drejta e pronësisë së trashëgimlënësit të saj, e njohur nga shteti me vendimin e Komisionit të Pronave, d.m.th. të drejtën e parablerjes (në masën që ish e mundur të realizohej) dhe të drejtën e kompensimit për truallin e zënë.

Në këtë kontekst shtrohet pyetja nëse janë të vlefshme këto dy disponime. Sipas nenit 761/1 të Kodit Civil, “Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon”.

Atëherë, për rrjedhojë, shtrohet pyetja nëse e drejta e parablerjes konsiderohet një e drejtë reale. Duhet të kemi parasysh se e drejta e parablerjes mund të krijohet me ligj ose me kontratë. Në rastin në shqyrtim, e drejta e parablerjes e trashëgimtares së ish-pronarit për objektet mbi truallin e ish-pronarit (trashëgimlënësit të saj) është një e drejtë parablerje ligjore. Në këtë rast e drejta e parablerjes e njohur nga ligji mund t`u kundrejtohet të tretëve dhe titullari i saj mund t`ia kërkojë sendin çdo të treti që e ka fituar atë. Për këtë arsye, parablerja ligjore konsiderohet si e drejtë reale (që ndjek sendin), ndërsa e drejta e parablerjes e krijuar me kontratë ka vetëm efekte detyrimi. Theksojmë se kjo nuk ka lidhje me çështjen në shqyrtim.

Si përfundim, e drejta e parablerjes e ish-pronarit (trashëgimtarit të tij), e parashikuar nga neni 21 i ligjit 7698, datë 15.04.1993, duke qenë e drejtë parablerjeje e krijuar me ligj, konsideratë e drejtë reale dhe, si e tillë, sipas nenit 761 të Kodit Civil, mund të disponohet duke ua kaluar të tretëve me dhurim.

Në vijim të arsyesimit tonë, shtrohet pyetja nëse është i vlefshëm kalimi tek i padituri Halil i së drejtës së kompensimit të truallit të ish-pronarit në masën 1/7 pjesë të trashëgimtares Sofije Bardhi, sipas disponimit që ajo ka bërë. Edhe e drejta e kompensimit të ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) është një e drejtë e njohur me ligj. Kjo e drejtë buron nga e drejta e pronësisë së ish-pronarit dhe lind për shkak të pamundësisë së kthimit (restitucionit) të pronës së tij. Edhe kjo e drejtë mund t`i kundrejtohet çdo personi të tretë që mund të jetë bërë pronar me mënyra të tjera i truallit në fjalë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993. Në praktikë ka mjaft raste që komisionet e pronave i kanë quajtur troje të caktuara të zëna në kuptim të ligjit të mësipërm, dhe nuk i kanë kthyer, por më vonë organizma të caktuara shtetërore, si p.sh. këshillat e regjistrimit të territorit i kanë miratuar ato si sheshe ndërtimi për persona të tretë. Në raste të tilla, ish-pronarë (trashëgimtarët e tyre) janë legjitimuar në kërkimet e tyre për kthimin e këtyre trojeve, nëpërmjet anulimit të vendimeve të komisioneve të pronave dhe të akteve të tjera administrative që kanë disponuar në favor të personave të tretë, duke i pajisur ata me sheshe ndërtimi.

Prej arsyesimit të mësipërm arrihet në përfundimin që edhe e drejta e kompensimit të ish-pronarëve, sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, duhet të konsiderohet si një e drejtë reale e vendosur me ligj. Duke qenë e tillë, ajo mund të disponohet me anë dhurimi prej titullarit të saj. Pra, kontrata e dhurimit në favor të të paditurit, edhe për këtë disponim duhet të konsiderohet e vlefshme. Gjithsesi, edhe po të pranohet të kundërtën, d.m.th. që e drejta e kompensimit në këtë rast nuk është e drejtë reale, por e drejtë detyrimi, përsëri disponimi në favor të të paditurit do të ishte një veprim juridik i vlefshëm. Në këtë rast, kjo pjesë e kontratës, pavarësisht vendosjes nën titullin e përgjithshëm si kontratë dhurimi, në fakt do të përbente një kalim (cedim kredie). Pra, do të pranohej se trashëgimtarja e ish-pronarit kredinë e saj ndaj shtetit, të lindur për shkak të së drejtës së kompensimit të pronës, ia ka kaluar të paditurit.

Fakti që ky disponim është inkluduar së bashku me pjesën tjetër, që përbën një dhurim, dhe që të dy së bashku janë kryer duke respektuar formën noteriale, jo vetëm nuk do të përbënte shkak pavlefshmërie, por, përkundrazi, do të përmbante një garanci më tepër për vlefshmërinë dhe pavlefshmërinë e tij.

Nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i paditësve, sipas të cilit dhurimi është i pavlefshëm edhe për shkakun se është bërë për një pasuri të ardhshme dhe jo për një pasuri të tashme, duke iu referuar nenit 762 të Kodit Civil.

Sipas kësaj dispozite, “Dhurimi nuk mund të përmbajë, veçse pasurinë e tashme të dhuruesit. Në qoftë se përfshin pasurinë e ardhëshme, dhurimi është i pavlefshëm përse i takon kësaj”. Në rastin në shqyrtim, kemi të bëjmë me një pasuri të tashme të dhuruese. Kjo pasuri ka ekzistuar që në kohën e çeljes së trashëgimisë dhe është bërë efektive pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.7968, datë 15.4.1993, në bazë të të cilit është marrë vendimi i Komisionit të Pronave. Është e vërtetë që objekti i kontratës d.m.th. të drejtat e transferuara tek i padituri, nuk janë të përcaktuara përse i përket volumit të tyre, por, gjithësesi, ky objekt është i përcaktueshëm në kohë.

Gjithsesi, si e drejta e parablerjes e ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij), ashtu edhe e drejta e kompensimit të tyre, janë të drejta të tilla, për disponimin e të cilave nuk ekziston ndonjë ndalim i përcaktuar me ligj, as edhe mund të deduktohet për ndonjë ndalim disponimi lidhur me to për shkak të vetë natyrës së këtyre të drejtave. Gjersa nuk konkludohet për ndonjë përjashtim, duhet t'i referohemi rregullimit të përgjithshëm të parashikuar në nenin 162 të Kodit Civil, sipas të cilit “E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.”

Si rregull, të drejtat reale dhe, më tepër, të drejtat e detyrimeve, janë lehtësisht të transferueshëm tek të tretët, përveç kur kemi të bëjmë me një ndalim ligjor ose kur konkludohet që të drejtat kanë karakter ngushtësisht personal apo kur transferimi i tyre do të përbënte një non sens.

Në përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore arrijnë konkluzionet si më poshtë:

1. Neni 761 i Kodit Civil përcakton në mënyrë eksplicite se objekt i kontratës së dhurimit mund të jenë sende ose të drejta reale.

E drejta e parablerjes e ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) e njohur në nenin 21 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” konsiderohet e drejtë reale dhe, si e tillë, ajo mund të disponohet me anë të kontratës së dhurimit. E drejtë reale konsiderohet edhe e drejta e kompensimit për pronat që njihet se i përkasin ish-pronarit, por që nuk mund të kthehen, sipas përcaktimeve të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave të ish-pronarëve. Edhe e drejta e kompensimit të ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) mund të disponohet lirisht me anë dhurimi.

E drejta e parablerjes dhe e drejta e kompensimit e ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) përfshihen në konceptin e pasurisë së një personi, i cili në vetvete përfshin një gamë të gjerë të drejtash jo vetëm reale, por edhe personale (të detyrimit).

2. Neni 761 i Kodit Civil përcakton në mënyrë eksplicite se objekt i kontratës së dhurimit mund të jenë sende ose të drejta reale mbi sendet. Ndërsa, sipas nenit 705 të Kodit Civil, kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte, kundrejt pagimit të një çmimi. Duke lënë mënjanë elementin e kundërshtimit, që përbën një dallim thelbësor midis këtyre dy kontratave, e duke bërë midis tyre krahasimin përse i përket objektit, konstatohet se, ndërsa kontrata e dhurimit nga natyra e saj është kontratë për kalimin tek pranuesi i dhurimit i pronësisë së një sendi ose i të drejtave të tjera reale që i përkasin dhuruesit, objekti i kontratës së shitjes në kohën e sotme është shumë i gjerë. Ai përfshin jo vetëm kalim tek blerësi të së drejtës së pronësisë mbi sende të caktuara ose të të drejtave të tjera reale, por edhe kalim të të drejtave të tjera që i përkasin shitësit, mjafton që këto të drejta të jenë të disponueshme lirisht, pa pasur për to ndonjë ndalim që parashikohet në ligj apo që rrjedh nga vetë natyra e këtyre të drejtave, në veçanti nga karakteri i tyre ngushtësisht personal.

3. Ndërsa kontrata e shitjes ka karakter konsensual, kontrata e dhurimit është konsideruar si kontratë reale, d.m.th. ajo quhet e lidhur në çastin e dorëzimit të sendit të luajtshëm apo të paluajtshëm, që përbën objektin e saj (neni 764 i Kodit Civil).

Mirëpo, kur objekt i kontratës së dhurimit nuk janë sende, por të drejta të tjera mbi sendet, siç janë pjesët ideale (kuotat) në bashkëpronësi apo të drejta të tjera reale mbi sendet e të tjerëve, atëherë kontrata e dhurimit merr karakter konsensual.

Si përfundim, edhe kontrata e dhurimit të së drejtës së parablerjes të ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) dhe ajo e dhurimit të së drejtës së kompensimit për sendet që nuk mund të kthehen, në kushtet e ligjit “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”, konsiderohet kontratë konsensuale, d.m.th. që ajo të konsiderohet e lidhur, mjafton që dhuruesi të ketë shprehur, në formën e kërkuar nga ligji, vullnetin e tij për të bërë dhurimin dhe pranuesi i dhurimit, po në këtë formë, të ketë shprehur vullnetin për pranimin e dhurimit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485 pika “a” të K.Pr.Civile,

VENDOSËN:

Lënien në fuqi të vendimit nr.425, datë 7.9.2000 të Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Ky vendim për unifikimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Siç rezulton nga materialet e çështjes, trashëgimtarëve të Ismail Bardhit, me vendimin përkatës të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve, i është njohur pronësia mbi një sipërfaqe trualli dhe, meqënëse trualli është konsideruar i zënë është vendosur njohja e të drejtës së parablerjes për objektin e ish-shtypshkronjës dhe e drejta e kompensimit për një sipërfaqe tjetër trualli.

Me kontratën e dhurimit të datës 5.8.1996, Sofie Bardhi, si një nga bashkëtrashëgimtarët e Isuf Bardhit, i ka dhuruar pjesën e saj të pandarë të pronësisë (1/7) nipit të saj, të paditurit Halit Bardhi. Pala paditëse ka kërkuar në gjykatë pavlefshmërinë e kontratës së mësipërme të dhurimit, me pretendimin se dhuruesja ka kryer dhurimin e një prone që nuk i ishte kthyer nga komisioni i kthimit të pronave, por vetëm i ishte njohur si pronësi.

Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndyshimin e vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesë - padisë. Çështja është kaluar për unifikim të praktikës gjyqësore në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të përcaktuar nëse “e drejta e parablerjes” dhe “e drejta e kompensimit” të njohur ish-pronarëve në bazë të neneve 21 dhe 16 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” janë të drejta reale dhe a mund të transferohen ato me anë të dhurimit?

Çështja është kaluar për unifikim të praktikës gjyqësore, për faktin se Kodi Civil, në nenin 705 pranon se me anë të kontratës së shitjes mund të kalohet pronësia e një sendi dhe e një të drejte tjetër, në nenin 761 shprehet se me anë të kontratës së dhurimit mund të kalohet pa shpërblim pronësia e sendit ose e një të drejte reale.

Kolegjet e Bashkuara pranuan se e drejta e parablerjes, si edhe e drejta e kompensimit janë të drejta reale dhe se mund të kalojnë tek persona të tjerë me anë të kontratës së dhurimit, që gjykoj se është i gabuar, jo thjesht në pikpamje doktrinare, por që mund të ndikojë në mënyrë jo pozitive në qarkullimin civil.

“E drejta e parablerjes” më parë se të parashikohej si e drejtë që i njihet ish-pronarëve në bazë të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, në të gjitha kohët, ka qenë parashikuar në ligjin civil si një detyrim i bashkëpronarit që, para se të shiste pjesën e vet në bashkëpronësi të njoftonte edhe bashkëpronarët e tjerë, të cilët gëzonin të drejtën që të blinin këtë pronë. Edhe në Kodin Civil në fuqi është parashikuar e drejta e parablerjes.

E drejta e parablerjes, megjithë vjetërsinë si institut i së drejtës civile, si në teori ashtu edhe në praktikën gjyqësore nuk është trajtuar si e drejtë reale. Është, gjithashtu, i njohur fakti se legjislacioni ynë civil, si edhe i vendeve të tjera, i ka të përcaktuara të drejtat reale dhe ato formojnë një numur të kufizuar dhe nuk u është lënë e drejtë individëve që të krijojnë me marrëveshje të drejta të tjera reale përveç tyre. Kodi ynë Civil njih si të drejta reale, përveç pronësisë edhe uzufuktin, përdorimin e banimin dhe servitutet.

Të drejtat reale janë të drejta mbi sendin, dhe nga përmbajtja e ligjit që trajton secilin prej tyre, të drejtat reale përcaktohen si të drejta mbi sendin e të tjerëve. Pavarësisht se pronari i sendit mund të ndryshojë, të drejtat reale vazhdojnë ekzistencën e tyre mbi sendin. Për këtë arsye thuhet se të drejtat reale kanë të drejtën e ndjekjes, e cila është një e drejtë mbi sendin që u kundërshtohet të gjithë pronarëve të tjerë të mëvonshëm.

Për të arritur në përfundimin nëse e drejta e parablerjes është e drejtë reale, përveç njohjes së përcaktimit të bërë rreth përmbajtjes së tyre, do të ishte e nevojshme edhe marrja në analizë e ndryshimeve midis të drejtave reale dhe të drejtave të detyrimeve.

Është e njohur se të drejtat reale janë të drejta që njerëzit kanë mbi sendet, ndërsa të drejtat e detyrimeve mund të cilësohen si të drejta krediti, ose si të drejta personale. E thënë më thjeshtë të drejtat e detyrimeve janë të drejta të njerëzve kundrejt njerëzve të tjerë. Ato paraqiten si të drejta kundrejt detyrimeve personale ose si të drejta për një sjellje të caktuar, që përfshin një detyrim për të dhënë apo dorëzuar diçka, një detyrim për të bërë diçka ose një detyrim për të mos bërë diçka.

Nga analiza e kujdesshme e kuptimit të parablerjes parashikuar nga neni 204 i Kodit Civil dhe parablerjes së parashikuar në nenin 21 të ligjit “Për kthimin e kompensimin e pronave”, arrihet në përfundimin se e drejta e parablerjes nuk është një e drejtë reale, por është një e drejtë detyrimi (kredie).

Kështu, sipas nenit 204 të Kodit Civil bashkëpronari, para se t’ia shesë pjesën e vet në sendin e paluajtshëm një personi që nuk është bashkëpronar, ka detyrimin që të njoftojë me shkrim bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën. Edhe në ligjin e kthimit të pronave dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, ka të shprehura edhe detyrime të organit që kryen privatizimin që të vlerësojë edhe të drejtën e parablerjes së ish- pronarëve në rastin e shitjes së pronës shtetërore.

Nga ligjet e analizuar, jo vetëm nga përmendja e fjalës “detyrohet”, por në përgjithësi del se, e drejta e parablerjes paraqitet si një e drejtë jo mbi sendin, por si e drejtë që qëndron kundrejt detyrimit të personave të tjerë; konkretisht në detyrimin e bashkëpronarit të sendit që të mos kryejë shitjen pa bërë njoftimin e bashkëpronarëve të tjerë që kanë të drejtën e parablerjes. Pra, e drejta e parablerjes paraqitet si e drejtë për një sjellje të caktuar të të tjerëve dhe që qëndron në detyrimin e tyre për të bërë diçka.

Është, gjithashtu, i njohur trajtimi i të drejtave reale si të drejta absolute dhe i të drejtave të detyrimeve si të drejta relative. Gjithashtu, është e njohur që të drejtat reale gëzojnë mbrojtje absolute. Të drejtat reale janë të drejta që i takojnë një subjekti kundrejt gjithë subjekteve të tjerë, ndërsa të drejtat e detyrimeve janë të drejta që i takojnë një subjekti kundrejt një ose më shumë subjekteve të përcaktuar, ose që mund të përcaktohen. Bashkëpronari që ka të drejtën e parablerjes mund të kundërshtojë blerjen e sendit në bashkëpronësi nga secili person që bën këtë blerje, po kështu edhe personi që ka të drejtën e parablerjes nga ligji për kthimin e pronave mund të kundërshtojë blerjen me anë të privatizimit kundrejt cilitdo person. Në këtë mënyrë, paraqitet disi e vështirë që, nisur nga këto rrethana, të bëhet dallimi nëse e drejta e parablerjes është e drejtë reale apo e drejtë detyrimi. Por, nisur nga fakti se personat që mund të kenë përfituar nga mosrespektimi i të drejtës së parablerjes janë të përcaktuar ose të përcaktueshëm, duke patur parasysh edhe dallimet e tjera, mund të thuhet se e drejta e parablerjes është një e drejtë personale (detyrimi).

Ky dallim del edhe nga fakti se të drejtat reale mund të posedohen, prandaj ato mund të fitohen edhe në titull origjinal, ndërsa të drejtat personale (të kreditit) mund të fitohen nga një titull i prejardhur.

Në doktrinën e vendeve të tjera, e drejta e parablerjes dallohet si një kufizim kontraktor që i bëhet të drejtës për të disponuar dhe që është e lidhur me shitjen e sendit, dhe si e drejtë e parashikuar nga ligji.

Arsyetohe se, kur e drejta e parablerjes është e njohur nga ligji (e drejta e parablerjes reale) ajo mund t'i kundërshtohet të tretëve dhe titullari i saj mund t'ia kërkojë sendin çdo të treti që e ka fituar atë. Për këtë arsye, parablerja ligjore është parablerje reale, ndërsa e drejta e parablerjes e njohur nga kontrata ka vetëm efekte detyruese.

Ky qëndrim tregon për afërsinë që kanë të drejtat reale me të drejtat e detyrimeve, por përfundimi se e drejta e parablerjes ligjore është parablerje reale, edhe për arsyet që u shtjelluan, nuk mund të çojë në pranimin e të drejtës së parablerjes si e drejtë reale. Edhe sipas nenit 204 të Kodit Civil, në rast se bashkëpronari nuk jua afron bashkëpronarëve të tjerë sendin, por ua shet personave të tretë, bashkëpronarët mund të veprojnë ndaj të tretëve.

Nga tërësia e argumenteve të sipërme arrijmë në përfundimin se e drejta e parablerjes nuk është një e drejtë reale, por është një e drejtë personale, detyrimi. Ky përfundim është më i qartë lidhur me të drejtën e kompensimit, e cila nga shumica trajtohet për të njëjtat shkaqe si e drejtë reale. E drejta për kompensim, ndonëse është një e drejtë kredie, ashtu si edhe parablerja, prejardhjen dhe bazën e ka në të drejtën reale të pronësisë mbi truallin, që nuk u kthehet ish-pronarëve vetëm për shkakun se nga ligji konsiderohet i zënë, por kjo prejardhje nuk i kthen ato në të drejta reale.

Në bazë të nenit 21 të ligjit "Për kthimin e e kompesimin e pronave", kur trojet ose tokat bujqësore të tjetërsuara në truall, janë zënë me ndërtime të përhershme, pronarët kompensohen me kufijtë e shpronësimit edhe me obligacione shtetërore ose me sipërfaqe trojesh. Në rastin në shqyrtim nuk rezulton që ish-pronarët të jenë kompensuar me sipërfaqe trualli ekuivalent deri në momentin e bërjes së kontratës së dhurimit, duke ngelur kështu një kompensim me obligacione shtetërore. Për kompensimin me obligacione shtetërore, komisioni pajis ish-pronarët me vendimin përkatës mbi bazën e të cilit ai tërheq obligacionet me vleftën ekuivalente në degën e Bankës Shqiptare. Dihet se obligacionet janë të transferueshme në persona të tretë nëpërmjet shitblerjes së tyre ose nëpërmjet faljes.

Në rastin në shqyrtim nuk kemi transferim të obligacioneve shtetërore, për faktin se dhuruesja nuk dispononte në dorë obligacionin shtetëror, por dhurim të së drejtës për të përfituar nga shpërndarja e tyre në të ardhmen në raport me pjesën që i takonte si bashkëpronare e pronës së kompensuar. Gjithashtu është e qartë se: dhuruesja ka "dhuruar" "vetëm" të drejtën e saj të parablerjes .

Në rast se dhuruesja do të ishte bashkëpronare së bashku me paditësat në një pasuri të paluajtshme, që mund t'i ishte kthyer nga komisioni i kthimit të pronave, mund të shiste pjesën e saj të pandarë, por para se ta kryente shitjen duhet t'ia afronte atë bashkëpronarëve, paditësve (e drejta e parablerjes). Gjithashtu, ajo mund të dhuronte sendin e paluajtshëm dhe në këtë rast bashkëpronarët nuk mund të pretendonin të drejtën e parablerjes.

Duke qenë se personi në shembullin e sipërm ka të drejtë të shesë sendin, duke respektuar rregulla të caktuara, ta dhurojë atë, përse nuk ka të drejtë që të dhurojë një të drejtë më të vogël se pronësia dhe e drejta reale?

Pengesa për këtë "dhurim" vjen nga përmbajtja e nenit 761 të Kodit Civil, i cili, ndryshe nga nenet 705 dhe 757, që bëjnë fjalë për kontratat e shitjes dhe shkëmbimit dhe lejojnë kalimin e pronësisë së sendit dhe të të drejtave të tjera, shprehet se: "Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon". Kjo dispozitë (për mendimin tim omëtim i ligjvënësit) megjithëse nuk shprehet në mënyrë eksplicite për ndalim e dhurimit të të drejtave të tjera, duke qenë se pranon dhurimin e të drejtave reale, nuk e lejon dhurimin e tyre, pra të të drejtave të tjera.

Në këtë aspekt, ligji ynë ndryshon me atë të vendeve të tjera, ku koncepti i shitjes, shkëmbimit ose i dhurimit është formuluar nga ligji në mënyrë të tillë që të përfshijë, përveç transferimit të pronësisë, edhe transferimin e një të drejte tjetër. Në këto kushte, gjykata ka detyrë vetëm që të bëjë interpretimin e tij. Fakti që neni 761 e ka specifikuar kalimin e një të drejte reale, ndryshe nga sa është parashikuar për kontratën e shitjes dhe të shkëmbimit, interpretohet se kjo dispozitë nuk e lejon dhurimin e të drejtave të tjera.

Meqenëse gjykimi ynë është se e drejta e parablerjes dhe e drejta e kompensimit janë të drejta detyrimi, të drejta krediti, ato mund t'u kalohen personave të tjerë, duke respektuar dispozitat e neneve 499-507 të Kodit Civil. Në nenin 499 është parashikuar mundësia e kreditorit t'ia kalojë kreditin e vet një personi tjetër edhe pa miratimin e debitorit, me kusht që kredia të mos ketë karakter të ngushtë personal dhe kalimi të mos jetë i ndaluar nga ligji. Në dispozitat e mëpasme parashikohet se kalimi i kredisë bëhet me titull barësor dhe falas. Kalimi i kredisë duhet të bëhet me shkresë ndryshe nuk është i vlefshëm. Për mosmarrëveshjen në gjykim, del që e drejta e parablerjes nuk ka karakter të ngushtë personal, sepse organi që do të kryejë privatizimin ose kompensimin nuk është i interesuar në mënyrë të veçantë për individualitetin e personit. Nga ana tjetër ligji lejon kalimin falas të kredisë, me kusht që ajo të bëhet me shkresë.

Kontrata objekt gjykimi është cilësuar nga palët kontratë dhurimi, por dihet se natyra e një kontrate nuk del thjesht nga emri që palët i vendosin asaj. Është e nevojshme që të vlerësohet edhe vullneti që palët kanë dashur të shprehin. Si rrjedhim, për çështjen konkrete, nuk mund të arrihet në përfundimin nëse në thelb kemi të bëjmë me kalimin e një të drejte krediti, falas dhe e përpiluar me shkresë, për shkak të mungesës së të gjithë dokumenteve që nuk janë administruar gjatë gjykimit. Në këtë aspekt, bashkohemi me argumentimin tjetër të pakicës lidhur me argumentimin e bërë për prishjen e vendimit për shkak edhe të shkeljeve procedurale që janë lejuar në gjykim. Mbajtja e këtij qëndrimi, për mendimin tim, do të krijojë rrethana që nga ana e legjislatorit të ndërhyhet për rregullimin më të saktë të nenit 761 të Kodit Civil.

Gjyqtarë: V. Kondili, B. Caka, E. Sinoimeri, V. Bineri

MENDIMI I PAKICËS

Ne gjyqtarët Ylvi Myrtja dhe Spiro Spiro mendojmë se vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset dhe çështja duhet të kthehet për rigjykim për faktin se nga aktet e dosjes nuk rezulton të jenë sqaruar përfundimisht rrethanat e çështjes.

Objekti i mosmarrëveshjes ndërmjet palëve ndërgjyqjese është kontrata e dhurimit nr.7670/954, datë 5.8.1995 (neni 5 i Kodit të Procedurës Civile). Kontrata e dhurimit është lidhur ndërmjet znj. Sofie Bardhi dhe nipit të saj të paditurit Halil Bardhi. Në kontratë thuhet shprehimisht: "Jam pronare e 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, të rrjedhur nga trashëgimlënësi Ismail Bardhi, e pikërisht të një sipërfaqe toke të përbërë nga 3177 m2 e ndodhur aktualisht në lagjen nr.17 të qytetit të Durrësit ku sot ndodhen të ndërtuar shtypshkronja "10 Korriku", pallate, lulishte, etj. E drejta e pronësisë time me pjestarët e tjerë ku unë kam 1/7 pjesë të kësaj prone vërtetohet me regjistrimin në regjistrin e hipotekës nr.718, datë 12.7.1995. Pjesën time të pandarë ia dhuroj nipit tim Halil Bardhi".

Paditësit pretendojnë se dhuruesja ka dhuruar disa të drejta që nuk i ka fituar vetë. Sipas tyre, paditësit së bashku me dhuruesen, me vendimin nr. 434, datë 18.04.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vetëm janë njohur pronarë dhe të drejtën e pronësisë do ta realizonin më vonë nëpërmjet kompensimit dhe parablerjes, në përputhje me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993. Paditësit arsyetojnë, vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave na ka njohur një të drejtë, por nuk na ka kthyer pronë, d.m.th nuk kemi fituar të drejta pronësie. Dhuruesja Sofie Bardhi ka dhuruar një pronë që nuk e kishte fituar. Sipas nenit 762 të Kodit Civil, dhuruesi ka të drejtë të dhurojë vetëm pasurinë e tashme, atë që ka dhe, nëse dhurimi përfshin pasurinë e ardhshme, dhurimi për këtë pjesë është i pavlefshëm. Dhuruesja nuk ka fituar të drejta pronësie dhe, duke mos fituar të drejta pronësie, nuk mund të bëjë tjetërsime pronësie.

Është fakt i njohur, tashmë, që Kushtetuta e vitit 1976 kishte shpallur "de jure" monopolin e shtetit mbi çdo degë e nëndegë të ekonomisë. Në vitin 1991, me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" u shfuqizua kushtetuta e vitit 1976 dhe u sanksionuan, ndër të tjera, parimet themelore për krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut. Parimet e ekonomisë së tregut u shtjelluan edhe me ligje të tjera të hartuara dhe të miratuara nga Parlamenti Shqiptar. Me anë të këtyre ligjeve filloi procesi i "vetëshpronësimit" të shtetit në favor të pronësimit të individëve.

Krahas procesit të privatizimit të pronës shtetërore, shteti i ri demokratik mori përsipër detyrimin moral dhe ligjor për të vënë në vend padrejtësitë e shtetit të mëparshëm, në dëm të ish-pronarëve. Me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” shteti mori përsipër t’u kthejë ish-pronarëve ato prona që mund të ktheheshin faktikisht dhe juridikisht.

Detyra kryesore e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ishte konfirmimi nëse ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre, u ishte shpronësuar, konfiskuar, shtetëzuar apo marrë prona në çdo mënyrë të padrejtë.

Së dyti, sipas ligjit të mësipërm, komisionet e krijuara për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve duhet të hetonin:

- nëse prona është e pandryshuar apo ka pësuar ndryshime;
- është e lirë apo e zënë; dhe
- kur prona është truall, çfarë objektivash ka përsipër, nëse këto objekte janë privatizuar apo jo.

Në funksion të gjendjes, komisionet e kthimit dhe të kompensimit të pronave, pas njohjes të qënies ish-pronar përcaktojnë nëse prona:

- duhet të kthehet;
- duhet të kompensohet, të kompensohet në letra me vlerë, me lekë apo me pronë ekuivalente;
- duhet të përfitojë ish-pronari të drejtën e parablerjes për ndërtimet e bëra nga shteti mbi truallin pronë e tij.

Dhuruesja pretendon se ka fituar nga vendimi nr. 434, datë 18.4.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave:

- 1/7 e pronësisë të objektit ish-pronë e trashëgimtarëve të saj;
- 1/7 e të drejtës së parablerjes, të parashikuar nga neni 21 i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993; dhe
- 1/7 e të drejtës së kompensimit të parashikuar nga neni 16/b i ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993.

Me pretendimet e mësipërme është mbrojtur gjatë gjyqimit edhe i padituri Halil Bardhi, pranuesi i dhurimit.

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka pranuar pjesërisht kërkesë - padinë e paditësve, duke e konstatuar pjesërisht të pavlefshme kontratën e dhurimit me arsyetimin: I padituri duke mos ushtruar të drejtën e parablerjes nuk ka fituar të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale.

Vetëm për të drejtën e pronësisë të fituar me anë të kompensimit, siç parashikon vendimi nr. 434, datë 18.4.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kontrata e dhurimit është e vlefshme.

Gjykata e Apelit Durrës ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke rrëzuar padinë e paditësve si të pabazuar në ligj e në prova me arsyetimin se nëpërmjet kontratës së dhurimit është bërë kalimi i një të drejte reale mbi një send.

Nga provat e administruara nga Gjykata e Shkallës së Parë Durrës dhe të pranuar nga Gjykata e Apelit Durrës nuk del se çfare të drejtash kanë fituar trashëgimtarët e ish-pronarit. Për pasojë, nuk del se çfarë të drejtash ka fituar dhuruesja.

Nga aktet e dosjes, nuk është përcaktuar dhe individualizuar trualli me sipërfaqe 3177 m², për të cilin është njohur e drejta e pronësisë ku ndodhet ai, cilat prej objekteve të shtypshkronjës “10 Korriku” ndodhen mbi këtë sipërfaqe, objektet e ndodhura mbi këtë sipërfaqe janë privatizuar apo jo.

Në dosje nuk është administruar vendimi origjinal nr. 434, datë 18.4.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Përmbajtja e këtij vendimi del në mënyrë të prejardhur nga tri prova të administruara për këtë fakt. Keto prova janë :

1. shkresa nr. 288/1, datë 20.4.1994 e hartuar nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Durrës, dërguar Degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dega Durrës;
2. vërtetimi i pronësisë, lëshuar nga Zyra e Hipotekës Durrës, datë 12.7.1995; dhe
3. vërtetimi i pronësisë i lëshuar nga Zyra e Hipotekës Durrës, më datë 27.11.1996.

Nga shkresa nr. 288/1, datë 20.4.1994 dhe vërtetimi hipotekor i datës 12.7.1995 del e njëjta përmbajtje dhe konkretisht: "... të njohë të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve të Ismail Bardhit mbi një sipërfaqe tokë prej 3177 m2.

Mbi këtë sipërfaqe ka qenë ndërtuar shtëpia e tyre, shteti për efekt të planit rregullues prishi shtëpinë e ngritur dhe u ndërtuan lulishte, pallate dhe një pjesë e shtypshkronjës "10 Korriku".

Në bazë të nenit 21 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 dhe udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 18.10.1993, pika 5, i lind e drejta e parablerjes.

Sipërfaqja e truallit që zë prona e pronarit në shtypshkronjë është 1140 m2, nga këto sipërfaqe ndërtimi janë 342 m2 (në korpusin qëndror), ndërsa 798 m2 janë sipërfaqe funksionale (oborr). Ndërsa diferenca prej 2037 m2 i kompensohet në bazë të nenit 16 pika "a" e ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993".

Vërtetimi i pronësisë i datës 17.11.1996 është i ndryshëm nga vërtetimi i datës 12.7.1995. Në vërtetimin e dytë të pronësisë është fiksuar: "Vërtetohet se në favor të trashëgimtarëve të z. Ismail Bardhi është bërë shtesë e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me nr. 434/1, datë 5.11.1996 si më poshtë:

"Kjo sipërfaqe 1140 m2 i njihet, pra i kthehet dhe mbas blerjes së objekteve nga pronari, për këtë sipërfaqe, kjo pronë mbetet në pronësi të pronarit".

E drejta e parablerjes dhe e drejta e kompensimit prejardhjen e kanë në të drejtën reale të pronësisë mbi truallin që nuk u është kthyer ish-pronarëve për faktin se është konsideruar i zënë.

Ish-pronarët nuk rezultojnë që të jenë kompensuar, por do të kompensohen dhe sipas vendimit nr. 3025, datë 7.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Durrës do të kompensohen me truall ekuivalent.

Nga provat e mësipërme nuk del në mënyrë të qartë se ku bie konkretisht truallit me sipërfaqe 3177 m2, i njohur në pronësinë e trashëgimtarëve të ish-pronarit nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Në ç'raport është kjo sipërfaqe truallit me shtypshkronjën "10 Korriku."

Në provat që cituam më sipër, thuhet se: Mbi truallin me sipërfaqe 3177 m2 është ndërtuar një pjesë e shtypshkronjës "10 Korriku", por nuk përcaktohet sa është kjo pjesë. Nga aktet e dosjes, ky moment ngelet i errët dhe i pa sqaruar. Është e nevojshme të përcaktohet sipërfaqja e kësaj pjese dhe objektet që ndodhen mbi këtë pjesë, se me të lidhen drejtpërsëdrejti e drejta e parablerjes.

Në çështjen objekt gjykimi nuk vihet në diskutim qënia pronar dhe fitimi i kësaj pronësie me anë trashëgimi por volumi i të drejtave të parashikuara nga instituti i parablerjes.

E drejta e parablerjes parashikohet si nga Kodi Civil, ashtu edhe nga ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve". Baza ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, është neni 21 i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993. Në këtë dispozitë është sanksionuar: "Në trojet, tokat bujqësore ose jo bujqësore të zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte, etj., ish - pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi".

E drejta e parablerjes, e parashikuar nga neni 21 i ligjit nr. 7698, është një e drejtë e mundshme për t'u realizuar në potencë për ato objekte që janë ndërtuar nga shteti në tokën e ish - pronarit e vazhdojnë të jenë në pronësi të tij dhe që shteti vendos t'i privatizojë.

Gjykatat nuk kanë bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen. Nga provat e administruara nuk del e qartë jo vetëm pjesa që zë ndërtimi i shtypshkronjës, por nuk përcaktohet se me kë kufizohet truallit me sipërfaqe 3177 m2 në ç'pjesë të këtij truallit janë objektet që do të privatizohen me anë të parablerjes, çfarë janë këto objekte, pozicioni i tyre, kufitarët dhe ajo që është më kryesorja nëse këto objekte vazhdojnë të jenë në pronësi të shtetit apo janë shitur dhe kthyer në pronë private para daljes së vendimit nr. 434, datë 18.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

E drejta e pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, është një e drejtë e njohur dhe e garantuar. Paragrafi i dytë i nenit 41 të Kushtetutës përcakton mënyrat e fitimit të pronësisë. Sipas këtij paragrafi, prona fitohet me dhurim, me trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.

Prona është një e drejtë, është pushteti i një subjekti mbi një send të njohur dhe të garantuar në interesin e vetë titullarit.

Nga teksti i kontratës së dhurimit dhe provave të tjera nuk bëhen të njohura sendet objekt të së drejtës së parablerjes. Kontratata është një mënyrë e transferimit të pronësisë dhe të drejtave të tjera. Në kontratën objekt gjykimi nuk vihet në diskutim vullneti i palëve kontraktuese, as shkak i lidhjes së kësaj kontrate, as forma, por objekti i kontratës. Për të arritur në konkluzione të sakta duhet të analizohet nëse objekti i kontratës së dhurimit është:

- i mundshëm,
- i ligjshëm,
- i përcaktuar ose që mund të përcaktohet.

Thelbi i fitimit të pronësisë, me titull të prejardhur, qëndron në faktin që pronari i ri e fiton pronësinë mbi sendin, vetëm në qoftë se tjetërsuesi është pronar i tij. Këtu vlen të theksohet parimi sipas të cilit asnjëri nuk mund t'u transferojë të tjerëve më shumë të drejta nga sa ka ai vetë.

I padituri ka pretenduar se dhuruesja ka fituar të drejta reale mbi disa sende pronë e shtetit me anë të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, por nuk i përcakton këto sende. Sipas të paditurit, këto të drejta i kanë kaluar atij me kontratën e dhurimit.

Me provat e administruara, nuk mund të konkludohet se çfarë të drejtash kanë fituar trashëgimtarët e ish-pronarit dhe konkretisht dhuruesja Sofie Bardhi. Pa u përcaktuar të drejtat e fituara nuk mund të diskutohet për transferimin e këtyre të drejtave. Pronari nuk mund të kalojë më shumë të drejta se ato që ka.

Prandaj është e domosdoshme të administrohej vendimi nr. 434, datë 18.4.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (neni 467/e e Kodit të Procedurës Civile) dhe skica shoqëruese. Gjithashtu, ishte e nevojshme të hetohej, duke thirrur ekspert dhe duke marrë prova të tjera, nëse ka apo jo objekte mbi truallin e ish - pronarit, cilat janë këto objekte, janë privatizuar apo jo, se në qoftë se objektet janë privatizuar e drejta e parablerjes nuk mund të realizohet. Duke mos u realizuar e drejta e parablerjes, kjo e drejtë nuk mund të transferohet tek të tjerët. Prandaj është e nevojshme të përcaktohen ndërtimet shtetërore që ndodhen mbi truallin e ish - pronarit.

Pa u përcaktuar të drejtat e fituara, ne gjyqtarët në pakicë mendojmë se nuk ka vend për njësimin e praktikës gjyqësore.

Gjyqtarë: S. Spiro, Y. Myrtja

VENDIM
Nr. 24, datë 13.3.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Artan Hoxha	“
Bashkim Caka	“
Metush Saraçi	“
Natasha Sheshi	“
Agron Lamaj	“
Perikli Zaharia	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Valentina Kondili	“
Vladimir Bineri	“
Ylvi Myrtja	“
Zamir Poda	“
Nikoleta Kita	“

Vladimir Metani “
Irma Bala “
Spiro Spiro “

në seancën gjyqësore të datës 13.3.2002, morën në shqyrtim çështjen civile nr. 19, që i përket:

**PADITËS I KUNDËRPADITUR: RAMADAN LLAPAJ
E PADITUR KUNDËRPADITËSE: VJOLLCA LLAPAJ
TË PADITUR:**

1. ISMIHAN PIRGU
2. KEMAL PASHALLARI
3. FLUTURA LLAPAJ

OBJEKTI I PADISË: Deklarimi i pavlefshëm i veprimit juridik, kontrata dhurimi.

BAZA LIGJORE: Neni 92 e vijues të Kodit Civil.

OBJEKTI I KUNDËRPADISË: Deklarimin e pavlefshëm të kontratave të dhurimit në favor të të paditurës Flutura Llapaj.

BAZA LIGJORE: Neni 92 e vijues të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1505, datë 27.4.1998, ka rrëzuar padinë dhe pranuar kundërpadinë, duke deklaruar të pavlefshëm kontratat e dhurimit me nr.11614 Rep. e Nr.5208 Kol. dhe nr.11615 Rep e nr.5209 Kol. datë 12.6.1996, si kontrata të fallsifikuara duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.829, datë 14.9.2000, ka lënë në fuqi vendimin e mësipërm të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka bërë rekurs paditësi i kundërpaditur, Ramadan Llapaj duke parashtruar këto shkaqe:

1. Bashkëshortët janë martuar në vitin 1966 dhe janë ndarë në vitin 3.5.1997.

Në vitin 1993 e paditura kundërpaditëse ka fituar disa prona nëpërmjet Komisionit të Kthimit të Pronave.

2. Kontratat e dhurimit janë të vitit 1994 e 1996, vlefshmëria e tyre përcaktohet nga dispozitat e Kodit Civil.

3. Neni 1167 i këtij Kodi (viti 1994) përcakton se bashkëpronësia zgjidhet sipas nenit 86 të Kodit Civil të 1981.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1292, datë 20.11-2001, ka vendosur dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me atë nëse ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-Pronarëve dhe ai për të përndjekurit politikë, janë mënyra fitimi pronësie dhe nëse duhet konsideruar pasuri bashkëshortore ajo e ardhur me trashëgim dhe e kthyer më vonë sipas këtyre ligjeve.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Artan Hoxha e Nikoleta Kita, mbrojtësen e paditësit të kundërpaditur, avokat Hanëme Bakia, e cila kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe pranimin e padisë, mbrojtësin e të paditurës kundërpaditëse, avokat Viktor Konomi, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr.829, datë 14.9.2000, është i bazuar në ligj e për këtë shkak duhet lënë në fuqi.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se palët ndërgjyqëse Vjollca Llapaj dhe Ramadan Llapaj kanë qenë bashkëshortë me njëri-tjetrin që nga viti 1966, deri sa është zgjidhur martesë mes tyre nga Gjykata e Tiranës në vitin 1997.

Paditësi i kundërpaditur Ramadan Llapaj ka ngritur padi ndaj të paditurës kundërpaditëse Vjollca Llapaj dhe të paditurve Ismihan Pirgu, Kemal Pashallari dhe Flutura Llapaj, duke kërkuar deklarimin e pavlefshëm të disa veprimeve juridike, kontrata dhurimi, me të cilat e paditura kundërpaditëse ka kaluar në pronësi të të paditurve të tjerë disa pasuri të paluajtshme. Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se sendet objekt i kontratave të dhurimit janë fituar gjatë martesës dhe, për rrjedhojë, i nënshtrohen regjimit martesor të bashkëpronësisë të parashikuar nga Kodi Civil i vitit 1981, regjim i cili për disponimin e sendeve të paluajtshme kërkon pëlqimin e të dy bashkëshortëve (neni 87/2). Kontratat e dhurimit janë lidhur në periudhat 1994 e 1996, kohë gjatë të cilës palët kanë qenë të martuar. Sipas paditësit, nuk është marrë pëlqimi i tij për tjetërsimin e kësaj pasurie të paluajtshme, e cila ka kaluar në favor të pranuesve të dhurimit të thirrur si të paditur në këtë gjykim.

Nga e paditura kundërpaditëse Vjollca Llapaj është pretenduar se pasuria që ajo ka fituar me trashëgimi ligjore, të cilën ajo e ka tjetërsuar me këto kontrata dhurimi në favor të të paditurve, njëkohësisht fëmijët e saj, nuk është pasuri bashkëshortore, por pronë vetëm e saj e, për këtë shkak, nuk ka qenë i nevojshëm pëlqimi i bashkëshortit tjetër për tjetërsimin e kësaj pasurie.

Nga gjykimi ka rezultuar se e paditura kundërpaditëse, me vendime të Bashkisë Tiranë dhe të Komisionit të Kthimit të Pronave, në vitet 1993 e 1994 ka përfituruar 1 /8 pjesë të trashëgimisë së trashëgimlënësve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi dhe Fehmi Kazazi, të cilët kanë qenë të shpronësuar dhe të konfiskuar nga shteti sipas ligjit të kohës në vitin 1950. Me këto vendime, trashëgimtarëve të tyre iu është njohur e kthyer pasuria, ku përfshihen ndër të tjera edhe e drejta e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, të cilat janë disponuar me kontratat e dhurimit që kërkohet të deklarohen të pavlefshme.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1505, datë 27.4.1998, ka rrëzuar kërkesë - padinë, ndërkohë që ka pranuar kundërpadinë, duke deklaruar të pavlefshme kontratat e dhurimit me nr.11614 Rep. e nr.5208 Kol. datë 12.6.1996 dhe Nr.11615 Rep. e nr.5209 Kol. datë 12.6.1996, për shkak të falsitetit të tyre. Në rigjykim, mbas prishjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të vendimit të mëparshëm, Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kolegji Civil, me vendimin e datës 20.11.2001, ka vendosur të kalojë aktet për unifikim të praktikës gjyqësore në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të shprehur ky i fundit lidhur me faktin se do të konsiderohet ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish - pronarëve dhe ai për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, si mënyrë e re e fitimit të pronësisë apo si korrigjim i një situatë të mëparshme të konsideruar në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në varësi të zgjidhjes së mësipërme, të përcaktojë nëse janë ose jo pasuri e përbashkët e bashkëshortëve sendet objekt i kontratave të dhurimit të sipërshënuara. Marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe pretendimet e ngritura më sipër për mënyrën e fitimit të pronësisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se është e nevojshme të unifikohet praktika gjyqësore, si më poshtë:

Ligji nr.7514, datë 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të përndjekurve politikë” dhe ligji nr.7698, dt.15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” nuk janë mënyra të reja të fitimit të pronësisë, por korrigjim i padrejtësisë së bërë dhe, për këtë qëllim, shfuqizojnë ipso lege të gjitha aktet e mëparshme ligjore, me të cilat u ishte marrë prona pronarëve padrejtësisht. Ato nuk krijojnë një situatë të re, (nuk kanë efekt konstituitiv), por ristabilizojnë ligjshmërinë dhe drejtësinë.

Shfuqizimi i akteve të sipërpërmendura, ka si efekt kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, duke rregulluar në masën më të mundshme, situatën e paligjshmërisë lidhur me të drejtën reale më të rëndësishme, atë të pronësisë (jo të drejta të tjera reale e aq më pak të drejtat e detyrimeve). Në këtë këndvështrim, kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është i plotë, por i pjesshëm (restitutio in parte). Njëpërmjet këtyre akteve normative u njihet e drejta e pronësisë ish-pronarëve, ose trashëgimtarëve të tyre, dhe u përcaktuan modalitetet për gëzimin efektiv të saj. Për shkak të kohës së gjatë të paligjshmërisë dhe pamundësisë objektive të kthimit fizik të të gjitha pronave të marra, ligji parashikon, për rastet kur kjo e para nuk është e mundur, alternativën e kompensimit.

Për të arritur në këto përfundime, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bazohen në interpretimin e vetë akteve normative të dala për këtë qëllim dhe shikimin e tyre në raport me situata juridike analoge, duke marrë për bazë gjithashtu, edhe mënyrat e fitimit të pronësisë:

1. Si rezultat i interpretimit historik përcaktohet kuptimi i një dispozite ligjore, duke u nisur nga qëllimi që ka ndjekur ligjvënësi në një kontekst të caktuar historik, në miratimin e një akti normativ. "Ekspozimi i motiveve" për miratimin e një ligji del në veçanti nga preambula e ligjit, në rast se akti normativ e ka një të tillë, si dhe nga tërësia e normave që e formojnë atë.

Në rastin në shqyrtim, në dallim nga teknika legislative e përdorur në përgjithësi në Shqipëri në hartimin e ligjeve ligji për pafajsinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish - të dënuarve dhe të pëmdjekurve politike, ka një preambul ku shpjegohet qëllimi dhe "eksponohen motivet" e ligjvënësit. Në preambulën e këtij ligji është pranuar se: "Gjatë 45 vjetëve, shumë qytetarë shqiptarë janë akuzuar, gjykuar, dënuar dhe burgosur, internuar, apo përndjekur, për shkelje të natyrës politike, duke dhunuar të drejtat e tyre civile, sociale, morale dhe ekonomike." Marrë për bazë këtë, ligji shprehet se ka për qëllim të krijojë një sistem juridik të drejtë e të ndershëm, të bazuar në të drejtat njerëzore dhe se përcakton masa për të kompensuar, rehabilituar dhe riintegruar në shoqëri të gjithë ata të cilët kanë vuajtur këtë dhunim të të drejtave të tyre. Ky ligj, në nenin 1, konsideron të pafajshëm dhe i quan të padënuar për efekte morale, politike, sociale dhe ekonomike të gjithë ata që janë dënuar për shkaqe politike. Ndër të tjera, në nenin 5, ligji ka parashikuar të drejtën e kthimit ose kompensimin e pasurive të konfiskuara.

Nga ana tjetër, edhe në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave ish - pronarëve", neni 1, nga i cili rezulton thelbi i ligjit, përcaktohet se: "Ky ligj u njez ish - pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore (duke përfshirë edhe ligjin nr.37, datë 31.1.1945 "Për tatimin a jashtëzakonshëm" nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompesimin e tyre".

Sikurse rezulton, këto akte normative, pasuar edhe nga ndryshime dhe përmirësime të mëvonëshme, kanë të njëjtin qëllim idem animus.- Ato, ipso lege kanë shfuqizuar efektet e akteve ligjore e nënligjore, si dhe vendimet e gjykatave veprimet e tjera, nëpërmjet të cilave është marrë padrejtësisht prona ish-pronarëve të ligjshëm nga shteti i asaj kohe. Ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative, ka njohur padrejtësinë, shkëlqen e të drejtave të pronësisë ish-pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre, duke iu kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi duke i kompensuar ato. Nga sa më sipër, rezulton se këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kish ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i saj ishin sende të paluajtshme.

2. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i konsiderojnë këto akte ligjore që u drejtohen ish-pronarëve apo trashëgimtarët e tyre, jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe e bëjnë efektive atë duke e bazuar edhe në argumente analogjike.

Si në titullin e ligjit (rubrica legis fit lex), ashtu edhe në përmbajtjen e tyre përdoret nocioni kthim i pronës. Me fjalë të tjera, kthimi i pronave ish - pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre është thelbi dhe qëllimi i këtyre ligjeve (anima legis dhe ratio legis).

Nocionin kthim i pronës ose, më saktë, kthim i sendit objekt i së drejtës së pronësisë, Kodi Civil e përmend në rastin e padisë për kërkimin e sendit (actio rivendicatio), neni 296 e vijues i tij. Në rastin, kur pranohet padia e rivendikimit, poseduesi jopronar duhet t'i kthejë sendin paditësit në favor të të cilit është njohur e drejta e pronësisë. Praktika gjyqësore ashtu edhe literatura juridike, në këto raste nuk kanë vënë kurrë në dyshim ekzistencën e së drejtës së pronësisë të pronarit joposedues, mbi sendin objekt të padisë së rivendikimit. Pronari joposedues nuk ka humbur për asnjë moment titullin e së drejtës së pronësisë, por vetëm posedimin e sendit. Pikërisht kjo është arsyeja pse ligji e kthen atë në situatën e mëparshme, duke i njohur të drejtën e kthimit edhe të frutave të sendit (restitutio in integrum), dhe kur kjo nuk është e mundur, pranon vetëm kthimin e sendit (restitutio in parte).

Në kohën e daljes së kuadrit ligjor për kthimin e pronave ish - pronarëve, ligjvënësi mund të parashikonte edhe rrugën gjyqësore të kërimit dhe kthimit të pronave të shtetëzuara apo konfiskuara padrejtësisht, por çmoi më të përshtatëshme rrugën administrative dhe të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve administrative të ngarkuara për këtë qëllim. Në rastin se do të pranohej zgjidhja e parë edhe analogjia do të ishte më e dukshme.

Për sa më sipër Kolegjet, sipas parimit të vjetër të së drejtës "ubi eadem est ratio, ibi eadem est solutio" vleresojnë se kur motivet janë të njëjta edhe zgjidhja duhet të jetë tillë.

3. Në arritjet e përfundimeve të saj, Gjykata ka, gjithashtu, parasysh mënyrat e fitimit të pronësisë të cilat ndahen në dy kategori të mëdha:

Mënyra me titull origjinale e fitimit të pronësisë, e njohur ndryshe si mënyra primare, kur pronësia mbi sendin fitohet për herë të parë, apo pavarësisht nga e drejta e pronarit të mëparshëm mbi të. Kjo mënyrë përfshin rastet e fitimit të pronësisë mbi sendin e gjetur, me bashkim e përzjerje, me parashkrim fitues, etj. si dhe me shtetëzim, shpronësim a konfiskim.

Mënyra tjetër e fitimit të pronësisë është ajo me titull të prejardhur, ku pronari i ri këtë titull e fiton nga pronari i mëparshëm si rezultat i një kontrate, apo si pasojë e vdekjes së tij, nëpërmjet çeljes së trashëgimisë. Në këtë rast, sendi transferohet nga pronari i mëparshëm në një pronar tjetër i cili konsiderohet si fitues i pronësisë.

Të paditurës kundërpaditëse, si rezultat i aplikimit të këtij legjislacioni, i është njohur e drejta e pronësisë mbi pronën e lënë nga trashëgimlënësit e saj, ashtu sikurse kanë përcaktuar aktet e organeve kompetente, respektivisht Bashkia Tiranë dhe Komisioni i Kthimit të Pronave të kësaj Bashkie. Me fjalë të tjera, ajo ka fituar pronësinë me titull të prejardhur, por që kjo pronësi për shkak të anomalisë ligjore sikurse u trajtua më sipër, u bë e mundur të ushtrohej efektivisht mbi pasurinë e trashëguar, vetëm si rezultat i ligjeve të cituara dhe të vendimeve të marra në zbatim të tyre nga organet kompetente. Pra, e paditura kundërpaditëse është fituese e pasurisë trashëgimore, ku përfshihen ndër të tjera edhe ato pasuri të palujtshme, për të cilat ka disponuar me kontratat dhurimi, që nga momenti i çeljes së trashëgimisë (ex tunc).

Marrë shkas nga kjo, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të rëndësishme për zgjidhjen e drejtë e të njëllotë të çështjeve të kësaj natyre në përgjithësi, krijimin e një mendimi unik lidhur me ligjin që aplikohet për marrëdhënien juridike të trashëgimisë, në rastin e konkurrimit në kohë të disa ligjeve që regullojnë këtë marrëdhënie.

Për këtë, Kolegjet unifikojnë praktikën gjyqësore si më poshtë:

Trashëgimia çelet në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, fizikisht të konstatuar ose të përcaktuar me vendimin gjyqësor të shpalljes së vdekjes. Përcaktimi i këtij momenti është i një rëndësie të veçantë praktike pasi në funksion të tij përcaktohet rrethi i trashëgimtarëve që thirren në trashëgimi, të drejtat e tyre dhe momenti i kalimit të së drejtës së trashëgimisë. Është ky moment, ai që përcakton edhe ligjin e aplikueshëm lidhur me efektet që pasojnë çeljen e trashëgimisë. Duke u bazuar në parimin ligji civil, si rregull, nuk ka fuqi prapavepruese (retroactive) dhe, në rastin konkret, as fuqi pasvepruese (ultraktive), arrijmë në përfundimin se ligji që i zbatohet marrëdhënies së trashëgimisë është ligji në fuqi në kohën e çeljes së saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të arritur në këtë konkluzion i referohen legjislacionit civil, dekretit "Mbi trashëgiminë" të vitit 1954, neni 2 të tij, Kodit Civil të vitit 1981, nenit 95 dhe nenit 318 të Kodit Civil në fuqi. Sipas këtyre dispozitave, por edhe ashtu sikurse praktika gjyqësore ka pranuar, momenti i çeljes së trashëgimisë është ai i vdekjes së trashëgimlënësit dhe ligji që aplikohet në këtë rast, është ligji që ka qenë në fuqi në atë kohë.

Duke iu referuar praktikës gjyqësore, rezulton ndër të tjera se Gjykata e Lartë, me vendim të Plenumit të saj nr.2, datë 28.2 dhe 2.3.1964, është shprehur se: "Për trashëgimitë e çelura përpara hyrjes në fuqi të dekretit "Mbi trashëgiminë zbatohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e çeljes së trashëgimisë".

Ky qëndrim i Plenumit të Gjykatës së Lartë është mbajtur edhe në praktikën e mëvonshme gjyqësore, gjë që ka buruar drejtpërdrejt nga legjislacioni civil, i cili, megjithëse i ndryshuar në vite, ka mbetur konsequent lidhur me momentin e çeljes së trashëgimisë dhe ligjin e aplikueshëm.

Në çështjen në gjykim, rezulton se e paditura kundërpaditëse dhe njëkohësisht dhuruese, Vjollca Llapaj, është një nga trashëgimtarët e trashëgimlënësve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi e Fehmi Kazazi, të cilët kanë vdekur respektivisht në vitet 1972, 1979 dhe 1981. Pasuria që ata kanë lënë në trashëgim, ka qenë pasuri e konfiskuar në favor të shtetit për shkaqe politike dhe që u është kthyer trashëgimtarëve të tyre, përfshi edhe të paditurën kundërpaditëse, me vendim të organeve kompetente në vitet 1993 e 1994. Duke qenë se e paditura kundërpaditëse ka hyrë në posedimin e një pjese të pasurisë trashëgimore në këtë periudhë, nga paditësi i kundërpaditur, duke marrë për bazë faktin se neni 86 i Kodit Civil të vitit 1981 është akoma në fuqi, e konsideron këtë pasuri si pasuri të ardhur (fituar) gjatë martesës e, për pasojë, bashkëshortore.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë pranojnë të drejtë arsyetimin e bërë nga Gjykata e Apelit Tiranë lidhur me ligjin e aplikueshëm për rastin në shqyrtim dhe pasojat që sjell ai për zgjidhjen e çështjes dhe nuk e gjejnë të bazuar pretendimin e paditësit kundërpaditës. Ashtu sikurse është arsyetuar më sipër, trashëgimlënësit e të paditurës kundërpaditëse kanë vdekur përpara hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, në kohën kur në fuqi ishte dekreti nr.1892, datë 5.7.1954 "Mbi trashëgiminë", Kodi i Familjes i vitit 1965 dhe dekreti nr.2083, datë 6.7.1955 "Për pronësinë". Për pasojë, ashtu sikurse edhe u unifikua, janë këto ligjet e aplikueshme për përcaktimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshorteve dhe regjimin juridik të saj. Sipas nenit 96 të dekretit "Mbi pronësinë", përcaktohet se: "Pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët u përkasin në tërësi të dy bashkëshortëve.

Në pasuritë e përbashkëta të bashkëshortëve nuk përfshihen sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim ose me trashëgim depozitat që ka secili në arkat e kursimit, sendet e përdorimit thjeshtë personal, si dhe sendet dhe veglat e ushtrimit të veprimtarisë ose mjeshtërisë së tyre ".

Duke marrë për bazë këtë përcaktim ligjor, rezulton se pasuria trashëgimore e fituar nga e paditura kundërpaditëse nuk duhet të konsiderohet si pasuri bashkëshortore dhe, për pasojë, si pronare e vetme ajo ka patur të drejtë ta disponojë atë me vullnet të lirë, edhe duke e tjetërsuar në pronarë të tjerë, në respektim të dispozitave ligjore në fuqi. Kontratat e dhurimit, me të cilat pasurinë e saj trashëgimore të përcaktuar në to, ajo ia ka dhuruar fëmijëve të saj pa pëlqimin e bashkëshortit, paditësit të kundërpaditur, janë veprime juridike të ligjshme dhe të vlefshme e për pasojë, nuk mund të shfuqizohen me vendim gjyqësor.

Fakti që e paditura kundërpaditëse u bë efektivisht sunduese e pasurisë trashëgimore vetëm në vitin 1993 dhe 1994, nuk ndryshon regjimin juridik të saj. Nuk duhet konfunduar momenti i fitimit të së drejtës, me momentin e gëzimit efektiv të saj. Këtë periudhë të kaluar, nga momenti i fitimit të të drejtës së pronësisë, deri në posedimin e pasurisë trashëgimore, literaturë juridike e konsideron si gjendje të trashëgimisë së pezulluar. Pra, fituesi i pasurisë trashëgimore, e paditura kundërpaditëse, për shkaqe të pavarura prej saj, nuk ka pasur mundësi të vihet në posedim të pasurisë trashëgimore, gjë të cilën ajo e bëri të mundur, vetëm pas korrigjimit të kësaj gjendjeje, me ligjet e referuara më sipër.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke marrë për bazë sa më sipër, arrijnë në përfundimin se e paditura kundërpaditëse me kontratat e dhurimit nr.1 1551 Rep. datë 29.6.1994, nr.1241 1 Rep. datë 17.12.1996, nr.12412 Rep. datë 17.12.1996, nr.12413 Rep. datë 17.12.1996, nr.12414 Rep. datë 17.12.1996, nr.12415 Rep. datë 17.12.1996 dhe nr.125 01 Rep. datë 19.12.1996, ka tjetërsuar pasurinë e saj, në favor të të paditurve Ismihan Pirgu, Kemal Pashallari dhe Flutura Llapaj, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, për pasojë, këto akte të përpiluara përpara noterit janë të ligjshme dhe vendimet e gjykatave të ankmuara janë të bazuara dhe duhen lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë",

VENDOSËN:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.829, datë 14.9.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore, sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, që njehson praktikën gjyqësore.

ARSYETIM PARALEL

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se, me vendim të Bashkisë dhe Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, është njohur pronësia e ish-pronarëve Hysni Mulleti, Aishe Kazazi dhe Fehmi Kazazi, të vdekur në vitet 1972, 1979 dhe 1981. Pronësia e njohur u është kthyer trashëgimtarëve të tyre, midis të cilëve edhe të paditurës kundërpaditëse Vjollca Llapaj, që ka përfutuar 1/8 e trashëgimisë.

E paditura kundërpaditëse ka qenë e martuar që nga viti 1966 me paditësin e kundërpaditur Ramadan Llapaj dhe martesë ndërmjet tyre është zgjidhur në vitin 1997. Gjatë kohës së martesës, në vitet 1994 dhe 1996, e paditura kundërpaditëse Vjollca Llapaj, me disa kontrata dhurimi, i ka kaluar në pronësi të paditurve të tjerë pjesë të pasurisë së njohur dhe kthyer si trashëgimtare e ish-pronarëve.

Paditësi i kundërpaditur ka pretenduar se sendet objekt i kontratave të dhurimit janë fituar gjatë martesës dhe, në bazë të nenit 86 të Kodit Civil të vitit 1981, që është akoma në fuqi ato konsiderohen si pasuri bashkëshortore dhe nuk mund të dhuroheshin nga e paditura kundërpaditëse në vitet 1994 dhe 1996 pa dijeninë e tij si bashkëshort i saj.

Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Durrës, me të cilin ishte vendosur rrëzimi i kërkesë padisë dhe pranimi i kundërpadisë. Çështja është kaluar për unifikim të praktikës në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për t'u shprehur nëse do të konsiderohet ligji për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe ai për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-dënuarëve dhe të përndjekurve politike, si mënyrë fitimi pronësie apo si korigjim i një situatë të mëparshme dhe, në vartësi të zgjidhjes së mësipërme, të përcaktojë në se janë ose jo pasuri bashkëshortore sendet objekt i kontratave të dhurimit të përmendura.

Përgjithësisht jam dakort me unifikimin e qëndrimit se ligjet e cituara nuk janë mënyra të fitimit të pronësisë, por korigjim i padrejtësisë së bërë dhe që kanë si efek rregullimin në masën më të mundshme të paligjshmërisë lidhur me pronësinë. Nëpërmjet këtyre ligjeve shteti merr përsipër të njohë ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe t'i ripronësojë ata me ato prona që juridikisht dhe faktikisht është e mundur të kthehen. Këto ligje u njohin ish-pronarëve të drejtën e pronësisë dhe nëpërmjet kthimit që u bëhet nga organet e administratës ish-pronarët rivendosen në target e tyre si pronar, tagre këto që i kishin humbur nëpërmjet shtetëzimit, shpronësimit, konfiskimit, si dhe në çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga ana e shtetit.

Mendimi im i kundërt qëndron në lidhjen që bëhet për aplikimin e dispozitave që kanë të bëjnë me bashkëpronësinë bashkëshortore.

Është e drejtë të arrihet në përfundimin se e paditura kundërpaditëse është fituese e pasurisë trashëgimore që nga momenti i çeljes së trashëgimisë. Por nuk është i saktë rrëzimi i pretendimeve të paditësit të kundërpaditur vetëm nisur nga fakti se trashëgimlënësit e të paditurës kundërpaditëse kanë vdekur para hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, kur ishin në fuqi dekreti "Mbi trashëgiminë" i vitit 1954, dekreti "Mbi pronësinë" i vitit 1955 dhe Kodi i Familjes i vitit 1955, të cilët nuk i përfshinin në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve sendet që secili kishte fituar gjatë martesës me trashëgim, për këto arsye:

1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë mbajtur parasysh se parimi "Ligji civil si rregull nuk ka fuqi prapavepruese" bën përjashtim për bashkëshpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, për shkak të përcaktimit të bërë nga vetë ligji civil shqiptar.

Ne nenin 1167 të Kodit Civil që është në fuqi, në mënyrë të shprehur thuhet se "ligji nr.6340, datë 26.6.1981 "Për Kodin Civil", përveç dispozitave për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, shfuqizohet."

Kjo do të thotë se dispozitat e Kodit Civil të vitit 1981, lidhur me bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve janë ende në fuqi. Ligjvënësi në Kodin Civil ka përcaktuar, gjithashtu, në një dispozitë të veçantë (neni 231) se bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve rregullohet me dispozita të Kodit të Familjes. Aktualisht është në fuqi Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.6599, datë 29.6.1992, i cili nuk rregullon bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, e cila, siç u tha rregullohet nga Kodi Civil i mëparshëm.

Sipas nenit 86 të Kodit Civil të mëparshëm (1981), janë në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve, sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës. Efektet e këtij ligji do të shtrihen nga momenti i hyrjes së këtij ligji në fuqi dhe do të vazhdojnë përderisa ligji të mos jetë shfuqizuar.

Më parë se të hynte në fuqi Kodi Civil i vitit 1981, bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve është rregulluar nga Kodi i Familjes, miratuar me ligjin nr.4020, datë 23.6.1965, i cili në nenin 45, paragrafi i parë përcaktonte se “pasuria që ka një bashkëshort në kohën e lidhjes së martesës mbetet pasuri e tij”, ndërsa paragrafi i dytë e trajton natyrën juridike të pasurisë së vënë gjatë martesës, duke parashikuar se “Pasuria e fituar me punë nga bashkëshortët gjatë martesës, bëhet pasuri e përbashkët e të dy bashkëshortëve. Çdo marrëveshje e kundërt është e pavlefshme.” Në bazë të nenit 46 të Kodit të Familjes, sendet që secili ka fituar gjatë martesës me dhurim apo me trashëgimi nuk përfshihet në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, sepse ato nuk janë rezultat i punës së tyre. Këtë mënyrë trajtimi ligjor ka patur pasuria e bashkëshortëve edhe nga neni 96 i ligjit “Mbi pronësinë”, sipas të cilit “pasuritë e fituara me punë nga bashkëshortët gjatë martesës u përkasin në tërësi të dy bashkëshortëve.”

Kodi i Familjes së vitit 1965 dhe legjislacioni para tij, dhurimet dhe pasurinë trashëgimore nuk e konsideronin pasuri bashkëshortore, ndryshe nga rregullimi i bërë edhe aktualisht nga Kodi Civil, që konsideron si pasuri bashkëshortore çdo gjë të fituar nga bashkëshortët gjatë martesës, pra edhe pasurinë që vjen nëpërmjet trashëgimisë apo pasurinë që i vjen njërit prej bashkëshortëve nëpërmjet dhurimit.

Praktika gjyqësore dhe mendimet juridike kanë trajtuar edhe çështjen e efektit prapaveprues të ligjeve të dala pas çlirimit të vendit, për marrëdhënie pasurore të lindura midis bashkëshortëve që kanë lidhur martesë në kohën e legjislacionit të vjetër. Ky problem i diskutueshëm në atë kohë, ka gjetur trajtimin në nenin 170 të Kodit të Familjes (1966), që shprehet se “Dispozitat e këtij Kodi për marrëdhëniet personale të bashkëshortëve, si dhe për marrëdhëniet pasurore të tyre, zbatohen edhe për martesat e lidhura para hyrjes së tij në fuqi.

Duke qenë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm se ligji i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, edhe Kodi Civil i vitit 1981, ashtu si edhe Kodi i Familjes së vitit 1966, përta i përket pasurisë së bashkëshortëve ka fuqi prapavepruese, për asrye se vetë ligjvënësi e ka përcaktuar një gjë të tillë. Kështu, në paragrafin e dytë të nenit 352 të Kodit Civil të vitit 1981 është përcaktuar se “Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe për marrëdhëniet e pronësisë midis bashkëshortëve të lindura para hyrjes së tij në fuqi, në qoftë se nuk është pjesëtuar me marrëveshje të bashkëshortëve, me vendim gjyqësor ose me akt noterial.”

2. Shumica, nisur nga rregulli juridik me karakter të përgjithshëm se ligji i ri nuk vepron veçse për të ardhmen, mban indirekt qëndrimin se pasuria bashkëshortore do të përcaktohet nga ligji që ka qenë në fuqi në momentin kur njëri nga bashkëshortët fiton të drejtën e pronësisë të ardhur nga trashëgimia, në momentin e çeljes së saj. Në këtë mënyrë, për pronën që njihet dhe kthehet në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave do të kemi dy qëndrime; kur është fjala për: prona njohura e të kthyer si pasuri trashëgimore para vitit 1981, atëherë pasuria që vjen nga trashëgimia nuk do të konsiderohet si pasuri bashkëshortore, ndërsa kur vjen si pasuri trashëgimore pas kësaj periudhe, pasuria që vjen nga trashëgimia do të konsiderohet si pasuri e të dy bashkëshortëve pavarësisht se cilit prej tyre i vjen prona nëpërmjet trashëgimisë.

Nga ana tjetër qëndrimi i mbajtur nga shumica vendos në pozita pabarazie personat që fitojnë pronësinë si trashëgimtar në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve me personat e tjerë trashëgimtarë të pasurisë së paluajtshme që nuk trajtohen nga këto ligje.

Ndonëse ndodhen në pozitë të njëjtë juridike, me zgjidhjen e dhënë nga Kolegjet e Bashkuara ata do të trajtohen në mënyrë të diferencuar.

Kështu, dy bashkëshort kanë lidhur martesë në vitin 1966 dhe e kanë zgjidhur atë në vitin 1997 (si palët në gjykim). Për shkak të vdekjes së trashëgimlënësve në vitet 1972, 1979 dhe 1981 (si në rastin në gjykim) njëri nga bashkëshortët bëhet trashëgimtar i pasurisë së tyre. Në bazë të ligjit që ishte në këtë kohë në fuqi (para miratimit të Kodit Civil të vitit 1981) kjo pasuri e ardhur njërit bashkëshort me trashëgimi nuk konsiderohej si pasuri bashkëshortore. Por, siç u tha, martesë ka vazhduar edhe më pas, deri në vitin 1997, kur Kodi Civil i vitit 1981 edhe pasurinë e ardhur trashëgimi e konsideronte si pasuri bashkëshortore. Për shkak të fuqisë prapavepruese të dispozitave për pasurinë bashkëshortore që analizuam, do të trajtohet si e tillë edhe pasuria që kanë fituar bashkëshortët para se të hynte në fuqi Kodi Civil i vitit 1981. Ky ka qenë rregullimi ligjor i bashkëpronësisë ndërmjet bashkëshortëve dhe praktika gjyqësore e ndjekur mbas hyrjes në fuqi të Kodit Civil të vitit 1981, i aplikueshëm edhe aktualisht.

3. Ky qëndrim i mbajtur nga Kodi Civil i vitit 1981, lidhur me pasurinë bashkëshortore dhe që vazhdon të ngelet një dispozitë detyruese për zbatim për shkak se nuk është shfuqizuar me nenin 1162 të Kodit Civil të vitit 1994, është reflektim i drejtpërdrejtë i Kushtetutes së vitit 1976 dhe qëndrimit të njohur të asaj Kushtetute lidhur me pronën private. E trajtuar si bashkëpronësi në tërësi, bashkëpronësia bashkëshortore merr formën e bashkëpronësisë së detyruar dhe kështu, jashtë vullnetit të bashkshortit që ka fituar pronësinë për shembull me trashëgimi apo dhurim, nëpërmjet rregullimit të parashikuar nga ligji në fuqi, kthehet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, bashkëpronësi kjo që nuk lind nga vullneti i palëve, por nga vullneti i ligjit.

Krijimi në këtë mënyrë i bashkëpronësisë së detyruar të pasurisë bashkëshortore, edhe për pronësinë e fituar nga secili nëpërmjet rrugëve klasike të fitimit të pronësisë: bie ndesh me dispozitat kryesore kushtetuese, që njeh dhe mbron të drejtat themelore të pronësisë private dhe më pas edhe me Kushtetutën që përcakton në nenin 41, pika 2 se “Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Kodin Civil.”

Arsyetimi i mësipërm përputhet me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj nr.4/1994, me të cilin u shfuqizuan si antikushtetues nenet 12/1 dhe 17 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish- pronarëve”, për shkak edhe të krijimit padrejhtësisht edhe të bashkëpronësisë së detyrueshme, duke u shprehur se “...Bashkëpronësia në pjesë apo në tërësi në çdo rast krijohet mbi bazën e vullnetit të lirë e të marrëveshjes midis pronarëve të veçantë e jo në mënyrë të detyrueshme me imponim shtetëror dhe forcën e ligjit. Ajo mund të krijohet edhe nëpërmjet faktit juridik që sjell suksesim universal, siç është për shembull trashëgimia, por në çdo rast ajo nuk mund të qëndrojë pa vullnetin e bashkëpronarëve.”

Bazuar në argumentimet e mësipërme, jo vetëm në zbatim të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave apo të ligjit mbi amnistinë dhe rehabilitimin e të përndjekurve politikë, por në tërësi për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve, duhet të mbahet qëndrimi i legjislacionit shqiptar në kohën që njihet qoftë edhe me kufizime pronën private, si dhe qëndrimi i legjislacioneve aktuale të vendeve të tjera perëndimore që, bashkëpronësia bashkëshortore përfshin të mirat e fituara nga bashkëshortët qoftë edhe veç e veç gjatë martesës, duke përjashtuar të mirat që u përkasin atyre para martesës, ato të fituara nëpërmjet trashëgimisë apo dhurimit, të mirat materiale për përdorim të ngushtë personal si dhe ato që shërbenë për ushtrimin e profesionit.

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhet që bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, të pezullonin gjykimin dhe materialet t'i dërgoheshin Gjykatës Kushtetuese, e cila të shprehej për kushtetutshmërinë e dispozitave të Kodit Civil të vitit 1981 për bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve ose bazuar në parimin “ius cures lex” e drejta kuron ligjin- të unifikonte qëndrimin për pasurinë bashkëshortore, në përputhje me definicionin e dhënë më sipër. Mendimin tim e argumentova si arsyetim paralel, për arsye se qëndrimi i dytë më duket më i drejtë dhe se pavarësisht nga mendimi i ndryshëm dhe shkaqet e tij, zgjidhja e çështjes konkrete koicidon me atë të shumicës.

Gjyqtar: B. Caka

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 29.5.2002
Doli nga shtypi më 30.5.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 200 lekë